



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Programi studimor: Komunikimi ndërkombëtar

PUNIM I MAGJISTRATURËS

**“Multikulturalizmi si një model lehtësues në rajon
dhe në sistemin ndërkombëtar”**

Kandidat:

Antoneta Shabani

ID 30585

Mentor:

Prof. dr. Veton Latifi

Shkup, 2023

PËRMBAJTJA:

FALËNDERIM	3
DEKLARATA	4
Abstrakt	5
Абстракт	6
Abstract.....	7
HYRJE.....	8
1. PJESA E PARË	14
1.1. Koncepti i multikulturalizmit	14
1.2. Multikulturalizmi në vend dhe në rajon.....	18
1.3. Multikulturalizmi në sistemin ndërkombëtar	26
2. PJESA E DYTË.....	32
2.1. Multikulturalizmi si model i ri lehtësues në tejkalimin e paragjytimeve brenda komuniteteve - parë në prizmin e anketave	32
Anketa e parë:.....	33
Anketa e dytë:	38
Problemet e multikulturalizmit parë nga prizmi i ekspertëve.....	48
-Hipoteza nga anketat dhe intervista:	50
2.2. Multikulturalizmi si model i ri lehtësues në rajon dhe në sistemin ndërkombëtar	51
2.3. Edukimi multikulturor	56
2.4. Shumëgjuhësia në shoqëritë multikulturore	60
2.5. Mediat dhe komunikimi multikulturor	63
2.6. Roli i shoqërisë civile në kohezionin e shoqërive multikulturore	66
3. PJESA E TRETË	71
3.1. Impakti i multikulturalizmit në zgjidhjen e problemeve shoqërore	71
3.2. Sfidat dhe perspektivat e multikulturalizmit	77
PËRFUNDIM	80
Bibliografia / literatura dhe burimet.....	84

FALËNDERIM

Për finalizimin e këtij projekti hulumtues, falënderoj mentorin tim për ndihmën permanente në të gjitha etapat e studimit dhe shkrimit të kësaj teze të magjistraturës, prof. dr. Veton Latifin, i cili asnjëherë nuk ngurroi të më ofrojë asistencë profesionale dhe të domosdoshme për të gjitha dilemat.

Poashtu falënderoj për mbështetjen e plotë familjen time të ngushtë, në veçanti bashkëshortin tim, për ndihmën dhe mirëkuptimin, sikurse falënderoj edhe kolegët e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Dhe, falënderimin më të madh ia kushtoj Zotit të gjithëmëshirshëm për të gjitha mirësitë e Tij!

DEKLARATA

Unë kandidatja Antoneta Shabani deklaroj se ky punim me temë “Multikulturalizmi si një model lehtësues në rajon dhe në sistemin ndërkombëtar”, është punim i imi origjinal, duke respektuar të gjitha normat e nevojshme shkencore për një punim të këtij niveli.

Abstrakt

Punim i magjistraturës me temë “Multikulturalizmi si një model lehtësues në rajon dhe në sistemin ndërkombëtar”, paraqet një punim shkencor, përmes të cilit jap kontributin tim lidhur me multikulturalizmin dhe mundësitë e këtij koncepti për të qenë një model lehtësues në procesin e paqësimit mes kulturave dhe diversitetit shoqëror.

Multikulturalizmi si koncept relativisht i ri, me kalimin e kohës është futur ndjeshëm në shumë shoqëri dhe shtete të botës, madje duke u bërë edhe sistem edukimi që nga nivelet e para të shkollimit, përfshirë edhe vendet tona. Në këtë kontekst, multikulturalizmi gjenë vend edhe në shumë shtete dhe shoqëri evropiane, madje dhe ballkanike, pikërisht për shkak të stimulimit, diversitetit etnik, gjuhësor, racor e religjioz, shpeshherë duke u shndërruar edhe si mjet për paqësimin e raporteve të acaruar mes kulturave të ndryshme.

Në këtë punim analizojmë dhe studiojmë aspektet e ndryshme të funksionimit të multikulturalizmit në vend, rajon dhe botë, përmes anketave, intervistave dhe hulumtimeve tjera të zhvilluara në këtë temë. Gjithashtu, në mënyrë serioze u qasemi edhe sfidave të kohës me të cilat ballafaqohet multikulturalizmi sot, sikurse edhe perspektivave që e presim në të ardhmen.

Fjalët kyçe: multikulturalizmi, diversiteti, komunitetet, edukimi, mediat, sfidat

Абстракт

Магистерскиот труд на тема „Мултикултурализмот како олеснувачки модел во регионот и во меѓународниот систем“, претставува научен труд, преку кој давам свој придонес во однос на мултикултурализмот и можностите на овој концепт да биде олеснувачки модел во процесот на мирот меѓу културите и социјалната различност.

Мултикултурализмот како релативно нов концепт, со текот на времето е воведен во многу општества и земји во светот, дури стана и дел од образовниот систем. Во овој контекст, мултикултурализмот стана дел од многу европски држави и општества, дури и на Балканот, токму поради стимулирањето на етничката, јазичната, расната и верската различност, честопати преобразувајќи се во алатка за смирување на заладените односи меѓу различните култури.

Во овој труд ги анализираме и проучуваме различните аспекти на функционирањето на мултикултурализмот во земјата, регионот и светот, преку анкети, интервјуа и други истражувања спроведени на оваа тема. Исто така, сериозно им пристапуваме на предизвиците на времето со кои се соочува мултикултурализмот денес, како и на перспективите што ги очекуваме во иднина.

Клучни зборови: мултикултурализам, различност, заедници, образование, медиуми, предизвици

Abstract

Master's thesis on "Multiculturalism as a facilitating model in the region and in the international system", presents a scientific work, through which I give my contribution regarding multiculturalism and the possibilities of this concept to be a facilitating model in the process of peace between cultures and social diversity.

Multiculturalism as a relatively new concept, over time has been significantly introduced in many societies and countries of the world, even becoming an education system from the first levels of education. In this context, multiculturalism has become a part of many European states and societies, even the Balkans, precisely because of the stimulation of ethnic, linguistic, racial and religious diversity, often being transformed into a tool for pacifying the strained relations between of the different cultures.

In this work, we analyze and study the various aspects of the functioning of multiculturalism in the country, region and world, through surveys, interviews and other research conducted on this topic. Also, we seriously approach the challenges of the time that multiculturalism is facing today, as well as the perspectives we expect in the future.

Key words: multiculturalism, diversity, communities, education, media, challenges

HYRJE

Shoqëria multikulturore si një shoqëri është ku pjesëtarët e etnive të ndryshme jetojnë sëbashku me njëri-tjetrin, me një respekt të ndërsjellë. Multikulturalizmi ka rëndësi për çdo shoqëri bashkëkohore që përbëhet nga njerëz me origjinë etnike, kulturore dhe fe të ndryshme që jetojnë dhe veprojnë bashkarisht në të njëjtën hapësirë, me respekt reciprok.

Historikisht njerëzimi ka pasur kolorit të pasur në të gjitha trajtat dhe aspektet, që nga Greqia antike, Roma e lashtë, Bizanti, Perandoria Osmane e deri te shtetet e reja nacionale që lindën në shekujt XIX e XX.

Edhe në shekullin e XXI, shoqëritë mbeten kulturalisht heterogjene, ku shumica e vendeve kanë një përzierje individësh nga raca të ndryshme, prejardhje gjuhësore, përkatësi fetare, kështu që respekti dhe toleranca ndaj atyre që janë të ndryshëm është më se e nevojshme. Pra, multikulturalizmi ekziston vetëm në ato situata ku plotësohen disa norma, toleranca, liria individuale, integrimi, pjesëmarrja aktive në zhvillimin e tyre, bashkëpërgjegjësia për ngjarjet pozitive dhe negative që ndodhin brenda komunitetit, mosshfaqja e dhunës verbale ose fizike dhe ku njerëzit që janë të ndryshëm nga njëri-tjetri mund të bashkëjetojnë.

Maqedonia e Veriut deklarohet si një shtet shumetnik, mundohet të bën të mundur zhvillimin e multikulturalitetit në vend. Në shikim të parë duket se gjithçka funksionon shumë mirë sa i takon bashkëjetesës, në anën tjetër gjendja faktike flet ndryshe, meqë akoma kemi shkolla të ndara, kafeteri, teatro, qendra të shëtitjes, etj. me një fjalë pothuajse të ndarë në enklava. Më aktiv në këtë fushë janë organizatat joqeveritare të cilat bëjnë projekte të ndryshme rreth bashkëjetesës, mirëpo edhe këto funksionojnë me vështirësi, sepse aktiviteti i tyre varet nga donatorët e ndryshëm apo ambasadave të huaja në vendin tonë. Poashtu në këtë drejtim nuk mund të thuhet se janë në nivelin e detyrës as edhe komunat e përziera të cilat nuk angazhohen seriozisht për të përmirësuar bashkëjetesën. Komunat tona si „projekte multietnik” i quajnë festimet e Vitit të Ri apo përvjetorët e qyteteve, duke organizuar koncerte

muzikore me artistë të përzier dhe aq. Në këtë aspekt mjaft ngecin edhe mediat, të cilat fare pak i promovojnë projektet multikulturore.

Qëllimi i punimit është të arrijë deri te disa zgjidhje konkrete përmes rekomandimeve apo sugjerimeve progresive për këtë model, siç janë:

- Promovimi më i madh i vlerave multikulturore në të gjitha nivelet e mundshme shoqërore;

- Të nxitë institucionet shtetërore, qeverinë e ministritë, që nga projektet e shumta vjetore nacionale që realizon, të mbështesin sa më shumë projekte në fushën e multikulturës;

- Komunat e përziera të thellojnë bashkëpunimin mes organizatave jofitimprurëse, shoqërisë civile, shkollave të të gjitha niveleve, mediave dhe bizneseve lokale;

- Të bëhen ekspozita me autorë nga grupe të ndryshme etnike, pjesë teatrale me aktorë të etnive të ndryshme, festivale poetike, radio stacionet të kenë programe multietnike, etj.

- Të nxitë debatin shoqëror mes palëve të ndryshme për të dhënë zgjidhje konkrete për probleme konkrete, etj.

Multikulturalizmi është para çdo gjëje një teori për kulturën dhe vlerën e saj. Prandaj, për të kuptuar se çfarë është multikulturalizmi, është e domosdoshme që të sqarohet kuptimi i kulturës.

Përvoja multikulturore mund të shihet si një grumbullim i këndvështrimeve të ndryshme ndërkulturore. Tubimet ndërkulturore janë, në një kuptim më të gjerë, ato në të cilat një person ekspozohet ndaj praktikave ose këndvështrimeve të ndryshme kulturore.

Barrierat gjuhësore mbeten faktorët e rëndësishëm të mbajtjes së distancave sociale midis grupeve të ndryshme etnike duke pasur kujdes të posaçëm për tejkalimin e barrierave gjuhësore ndërmjet qytetarëve. Kjo mes tjerash mund të arrihet nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit në vendin e punës dhe konsiderohet si shumë e kënaqshme në veçanti për

sektorin e biznesit në të gjitha komunat e synuara. Poashtu me rëndësi të veçantë është edhe arsimimi për ecurinë dhe zhvillimin e marrëdhënieve pozitivendërmjet pjesëtarëve të komuniteteve etnike.

Mendohet se më së shumti lidhjet ndërmjet bashkësive dominuese në vend maqedonasve dhe shqiptarëve i prek zhvillimi i multikulturalizmit. Prandaj, shpeshherë vihet re se praktikave të diskriminimit u nënshtrohen pjesëtarët e bashkësive etnike që janë në numër më të paktë, në këtë rast shqiptarët, por edhe komunitetet tjera me numër dukshëm më të vogël, siç janë turqit, serbët, vllehët, romët apo edhe bullgarët, kroatët, etj.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të ekzaminojë prarinë e përvojës multikulturore te pjesëtarët e bashkësive etnike, zgjerimi i njohurive për gjuhët e huaja, njohja me veçoritë dhe interesimi për kulturat e tjera, qëndrimet, hapja ndaj të tjerëve, gatishmëria për veprim ndërkulturore dhe lëvizshmëri, pranimi i kulturave të tjera, eliminimi i paragjykimeve dhe aftësitë e nevojshme për funksionim në kultura të tjera, aftësitë, interpretimet dhe lidhjet, ndërveprimet, rrjetëzimi dhe gatishmëria për ndërveprim me pjesëtarët e kulturave të tjera komunikuese ndërkulturore.

Qëllimet specifike të hulumtimit janë:

- Testimi i modeleve për arsimim duke përfshirë të gjithë nxënësit në ngritjen e vetëdijes për bashkëjetesë dhe tolerancë;
- Ngritja e vetëdijes tek të gjithë pjesëmarrësit e komunitetit për dialog ndërkulturore;
- Trajnime të ndryshme për dialog multikulturore;
- Vizita dhe shkëmbime të praktikave ndërmjet bashkësive etnike;
- Futja e elementeve multikulturore në lëndët mësimore: shoqëri, histori, etikë, art apo edhe gjuhë e letërsi;
- Organizimi dhe pjesëmarrja e përbashkët në projektet multikulturore;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta për bashkëpunim ndërkulturore, etj.

Hipoteza e punimit lindi nga përvoja në terren se institucionet nuk ndjekin politika të qëndrueshme multikulturore ose integruese, pavarësisht udhëzimeve të institucioneve të Bashkimit Evropian (BE-së). Ashtu që me këtë rast do të përpiqemi që të identifikojmë çështjet kryesore që lidhen me multikulturalizmin në teori dhe praktikë.

Objekt i këtij hulumtimi është përvoja multikulturore e komuniteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV). Zhvillimi i përshpejtuar i teknologjive dhe shkëmbimit të informacionit mundëson zhvillim të shpejtë, midis kulturave të ndryshme dhe incidenca në rritje e migrimit në RMV, veçanërisht në mesin e popullatës së re.

Për përpunimin kualitativ është përdorur metoda e anketimit të qytetarëve të etniteteve të ndryshme me plotësimin e fletës anketuese. Poashtu informacioni është mbledhur edhe nga një kampion i rastësishëm duke u përdorur edhe intervista ballë për ballë. Hulumtimet kanë treguar se individët me përvojë të pasur multikulturore kanë më shumë gjasa të përdorin të menduarit krijues për të mbledhur ide nga kultura të ndryshme për të krijuar njohuri dhe zgjidhje origjinale.

Një tjetër metodë që është përdorur në këtë hulumtim është metoda krahasuese. Siç dihet, krahasimet mund të bëhen mes fushave, faktorëve dhe aktorëve të ndryshëm, apo edhe ndërmjet shteteve ose organizatave të ndryshme. Prandaj, është bërë krahasimi i përvojave multikulturore ndërmjet vendeve të rajonit dhe votës, në krijimin e klimës pozitive dhe lehtësuese në sistemin tonë dhe atë ndërkombëtar.

Poashtu është përdorur edhe metoda e analizës shkencore, duke bërë studimin e thelluar të atyre pjesëve të hulumtimit, me të cilat do të ndeshemi gjatë procesit të mbledhjes së materialeve të duhura për shkrimin e punimit.

Dhe një metodë tjetër, poashtu mjaft e zbatueshme në shkencat shoqërore, e cila është në zbatim është edhe metoda e sintezës, duke bërë bashkimin e disa teorive dhe hipotezave që do të dalin gjatë procesit të këtij studimi.

Hulumtimi është realizuar duke përdorur edhe dy anketa konkrete - pyetësorë në mesin e popullatës së re (maturantë, studentë) dhe heterogjene në aspekt të etnisë e religjionit në

Republikën e Maqedonisë së Veriut. Para plotësimit të pyetësorit, të anketuarit janë njohur me temën e hulumtimit dhe anonimitetin e pyetësorit. Duke marr për bazë metodën e hulumtimit, u vendosën detyrat e mëposhtme kërkimore, si: prania e përvojës multikulturore midis të anketuarve; nëse ka një ndryshim në nivelin e përvojës multikulturore lidhur me pjesëmarrjen e të anketuarve në programe të ndryshme multikulturore; nëse ka ndonjë ndryshim në nivelin e përvojës multikulturore në lidhje me gjininë e të anketuarve; etj. Gjithashtu është marrë edhe mendimi i ekspertëve të fushës, duke intervistuar njohësit më të mirë të temës së multikulturalizmit në vendin tonë.

Në hulumtim është përdorur metoda dhe procedura të kombinuara kualitative dhe kuantitative, kurse rezultatet pasqyrohen përmes deskripsionit narrativ, tabelave dhe ilustrimeve me shembuj.

Rishikimi i literaturës për shkrimin e punimit shkencor u bë në mënyrë të kujdesshme, fillimisht me shfletimin e të gjitha botimeve të mundshme shkencore në vendin tonë që trajtojnë temën e multikulturalizmit. Këtu dallohen studimet e autorëve, si Petar Atanasov, Ana Çupevska, Ali Pajaziti, Ylber Sela, Jasmina Trajkoska e të tjerë. Por kemi rishikuar edhe literaturën e autorëve të njohur botërisht, si: Will Kymlika, David Brown, Matthias Koeing, botime të qendrave më prestigjioze evropiane dhe amerikane të cilët në mënyrë më koncize e kanë trajtuar këtë temë. Qasja deri te këto burime ka qenë kryesisht online në formate pdf të librave dhe revistave shkencore ndërkombëtare. Një ndihmesë e konsiderueshme në këtë plan ka ardhur edhe nga studimet e ndryshme të OJQ-ve në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon, që implikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë tema të caktuara problemore. Janë shfrytëzuar po ashtu edhe dokumente të krijuara nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut, që flasin për orientime të reja në drejtim të koncepteve të multikulturalizmit, interkulturalizmit, etj.

Hulumtimi i paraqitur në këtë punim mban qëndrimin se shoqëritë multikulturore janë realitet dhe funksionimi i tyre është i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm për çdo kulturë. Poashtu duke pasur parasysh pikëpamjen e multikulturalizmit si politikë kulturore, arsimore, si koncept i shoqërisë në formë pasive imagjinare është i paarritshëm dhe i pashmangshëm që të ketë një depërtim-ndërkulturalizëm. Në vëzhgimin objektiv dhe kozmopolit të një shoqërie

multikulturore, duke pasur parasysh pengesat për funksionalitetin e saj, kemi një përfundim veçanërisht të rëndësishëm, i cili formon diskursin mbi multikulturalizmin. Domethënë, domosdoshmëria e ndërkulturalizmit dhe mënyrat e realizimit të tij e bëjnë të qëndrueshme shoqërinë multikulturore, që organizimi institucional dhe aparati shtetëror duhet të jetë më sensibil ndaj subjekteve të tij.

Ky hulumtim ka rëndësi të veçantë për kahet e sotme të zhvillimit shoqëror. Ai i jep një orientim të caktuar shanseve pozitive dhe negative të shoqërive multikulturore ballkanike, të cilat kanë ngecje në më shumë segmente. Funksionimi i shoqërive multikulturore arrihet duke ndërtuar vetëdijen për veten dhe kulturën tonë në raport me kulturat e tjera, prandaj këto vlera paraqesin imperativ të paevitueshëm për të sotmen dhe të ardhmen.

1. PJESA E PARË

1.1. Koncepti i multikulturalizmit

Multikulturalizmin për ta kuptuar është e domosdoshme të sqarojmë kuptimin e kulturës, edhe pse nuk është aq lehtë, për vetë faktin se kultura është një term aq i gjerë, sa që për të janë dhënë më tepër se 300 definicione nga sociologë, politologë, filozofë e shkrimtarë të ndryshëm.

Siç dihet, fjala “kulturë” është një nga fjalët e shumta latine të cilat mund të hasen në pothuajse të gjitha gjuhët evropiane. Kjo fjalë është krijuar nga folja latine “colo” që do të thotë: përpunoj, kultivoj, përkujdesem, kujdesem për diçka. Prej këtui, kuptuar në mënyrën më të thjeshtë, në esencë “kultura” është një sjellje kujdesi ndaj diçkaje, përpunimi dhe rregullimi, fisnikërimi dhe zbutjeje.

Në fakt, termi “kulturë” është një element i përditshëm i vokabularit tonë, si në shtëpi, në shkollë, në universitet, në punë, në ekranet e televizorit, faqet e gazetave e librave. Pra, kudo që jemi kulturën e kemi me vete, qoftë në përkufizimin e mënyrës së sjelljes, qoftë në përkufizimin e mënyrës së veshjes, qoftë në përkufizimin e mënyrës së të shprehurit, qoftë në përkufizimin e mënyrës së të ushqyerit apo qoftë në raportin me të kaluarën, me trashëgiminë familjare, etnike, gjuhësore, historike, religjioze, etj. Pra, nga vetë këto manifestime të ndryshme të kulturës, nënkuptojmë edhe definicione dhe përkufizime të shumta të termit kulturë, në esencë paraqet një proces të gjatë interference njerëzore ndaj sendeve dhe objekteve të dhëna natyrore, por edhe të përvojave dhe pasurive shpirtërore të njerëzimit. „Pra, kultura është një lloj tërësie e realizimeve të përgjithshme dhe artikulimeve të formave e të shprehjeve të tija historike, individuale dhe kolektive - praktike, estetike, teorike, mitike dhe religjioze.” (Skallovski, Prvo lice ednina, Shkup 2010)

Ndërsa, tani në fillimin e këtij shekulli, nocioni për kulturën fiton kuptime tjera. Duke u nisur nga kjo se nocioni i kulturës merr kuptime tjera edhe Ginters Gras e quan „kultura e re sekundare” sipas tij zhvillohet një vetëpromovim masovik dhe ritual i kulturës, e ndihmuar nga mediumet elektronike. Poashtu shumë autor me ndikim si: Teri Ingëllton, Mishel Fuko, Zhil Delez, Feliks Gatari, Zhak Derida, Riçard Rorti, Çarlis Tejllor e shumë të tjerë potencojnë po edhe e pranojnë kulturën si instrument politik. „ Këto dy attribute të kulturës kontribuan për “pluralizmin kulturor” i cili e hapi derën për temat siç janë: shoqëritë pluraliste dhe të segmentuara ose shtetet mozaike, shoqëritë disjunktive ose të ashtuquajturat “shoqëri të panjohura”, e të ngjashme” (Çupeska, 2013: 11).

Pra, derisa kemi krijuar një koncept të caktuar për termin “kulturë”, bashkimi i tij me termin e ri “multi”, që në latinisht donë të thotë “shumë”, krijon termin krejtësisht të ri - “Multikulturalizëm”. Pra, në një përkthim të shpejtë në gjuhën shqipe, për multikulturalizmin, rrjedhimisht do të mund ta përdornim termin “shumëkulturalizëm” ose “shumëkulturësi”. Megjithatë, termi multikulturalizëm ka hyrë në përdorim të gjerë edhe në gjuhën tonë shqipe, si një shprehje internacionale, dhe si të tillë do ta përdorim edhe ne në këtë punim shkencor.

Siç dihet, termi "multikulturalizëm" s'është atribut evropian, ai u shfaq fillimisht në Kanada, SHBA në shekullin e kaluar të viteve 60-ta, për të treguar gjendjen e larmisë etnokulturore, racore dhe fetare të popullsisë në vendet e krijuara kryesisht nga emigracioni. Në vitin 1969, në Kanada u shpall barazia e anglishtes dhe frëngjishtes, ndërsa që nga viti 1971, ky shtet zyrtarisht u përcaktua vetë si një shoqëri multikulturore e bazuar në dygjuhësinë anglo-franceze. Qëllimi u shpall për ta bërë shtetin më të ndjeshëm ndaj nevojave të qytetarëve të tij nga të gjitha grupet kulturore dhe gjuhësore. Jozyrtarisht, besohej se për qeverinë, multikulturalizmi ishte dhe mbetet një mënyrë për të devijuar debatin politik nga konfrontimi midis anglofonëve dhe frankofonëve në Kanada, dhe kështu të shmanget polarizimi i mëtejshëm i shoqërisë kanadeze.

Kështu, multikulturalizmi, si një fenomen relativisht i ri u bë modeli i tretë me ndikim në zgjidhjen e një problemi kompleks në lidhje me heterogjenitetin kulturor, etnik, racor dhe fetar të shteteve që përbëjnë shumicën absolute në botë. Ndërsa, vlerësohet se vetëm 10% e

vendeve në botë mund të konsiderohen si homogjene kulturore ose monokulturore, që donë të thotë se afër 90% e vendeve të botës janë shoqëri të përziera - multikulturore.

Multikulturalizmi si definicion më të përhapur nënkupton bashkëjetesën e njerëzve të kulturave të ndryshme, si shoqëri heterogjene, që kanë një vizion të qartë dhe të përbashkët për një bashkëjetesë, duke u respektuar dhe pranuar të gjitha identitetet kulturore. Për shoqëritë moderne respektimi i multikulturalizmit është një nga kushtet kryesore. Kjo nënkupton thyerjen e barrierave të ndryshme të krijuara në mes shoqërive dhe vendosjen e raporteve miqësore mes tyre. Postulati kryesor i multikulturalizmit është inkluziviteti, e kjo njëherësh nënkupton se nuk duhet të hidhen poshtë vlerat dhe traditat e tua, që të bëhesh multikulturore, por se njëkohësisht as nuk duhet të nënçmohen vlerat e të tjerëve që janë të ndryshme nga tuajat.

Koncepti i multikulturalizmit brenda filozofisë politike bashkëkohore në terma të përgjithshëm është përcaktuar në dy mënyra të ndryshme. Ndonjëherë përdoret si koncept përshkruar, e herë të tjera përkufizohet si një lloj politike për t'iu përgjigjur diversitetit kulturor. Më poshtë do të shpjegojmë se çfarë është përkufizimi i multikulturalizmit si koncept përshkruar si dhe një sqarim rreth përdorimit të termit ,multikulturalizëm' si politikë.

Ka raste kur termi ,multikulturalizëm' përdoret për të përshkruar edhe një gjendje të caktuar të shoqërisë, e saktësisht përdoret për të përshkruar një shoqëri ku bashkëjetojnë një shumëllojshmëri kulturash të ndryshme. Në botë shumë vende kanë larmi kulturore, p.sh. Kanadaja është vetëm një nga shembujt, duke përfshirë shumëllojshmëri kulturash kombëtare, si kanadezët anglezë, amerikanët vendas, amishët, kubekoit, huteritët dhe emigrantët kinezë. Poashtu edhe Kina zë një vend të veçantë sa i përket një larmie të madhe kulturore, ku sot numërohen 56 grupe etnike të njohura zyrtarisht, nga të cilat 55 prej këtyre janë pakica etnike që afërsisht përbëjnë 8 për qind të popullsisë së përgjithshme të këtij vendi të madh aziatik. Poashtu, ndoshta mënyrat kryesore në të cilat një vend mund të jetë i larmishëm kulturor është duke pasur grupe të ndryshme fetare, grupe të ndryshme gjuhësore, grupe që përcaktojnë veten nga identiteti i tyre territorial dhe grupe të ndryshme racore. Sa i përket një vendi që fetarisht është i larmishëm si shembull mund të sjellim Indinë, duke përfshirë qytetarë që janë budistë, sikë, hindu në mesin e grupeve fetare të tjera. Gjithashtu është e larmishme

fetarisht dhe SHBA-ja, duke përfshirë mormonët, huteritët, katolikët, protestantët, ortodoksët, hamishët, myslimanët, hebrenjtë e të tjerë. Gjitha këto grupe dallojnë mes veti nga njëri – tjetri nëpërmjet një sërë faktorësh që disa prej tyre janë perënditë e adhuruara, festat fetare, festat publike si dhe kodet e veshjes.

Poashtu termi ,multikulturalizëm’ mund të përdoret për t’iu referuar një lloj politike e cila ka dy karakteristika kryesore. Së pari, synon adresimin e kërkesave të ndryshme të grupeve kulturore që do të thotë, se është një lloj politike që i referohet sfidave të ndryshme normative (joliberalizmi i brendshëm, konflikti etnik, autonomia federale, etj.) që lindin si rezultat i diversitetit kulturor. Marrë në përgjithësi politikat multikulturore synojnë korrigjimin e disavantazheve, në rastet kur disa individë janë viktimë të identitetit të tyre kulturor. Si shembull mund të marrim rastet kur grupet e caktuara të komunitetit myslimanë që jetojnë në një vend të krishterë, kërkojnë të festojnë institucionalisht festat e tyre fetare, siç është Fitër Bajrami apo Kurban Bajrami.

Së dyti, politikat multikulturore kanë si objektiva ruajtjen, lejimin ose kremtimin e dallimeve ndërmjet grupeve të ndryshme, çka do të thotë se politikat multikulturore janë politika që synojnë t’iu ofrojnë grupeve mjetet me të cilat individët mund të ndjekin dallimet kulturore. Nga gjithë e sipërpërmendur mund të vërejmë se politikat multikulturore janë në kontrast me asimilimin, sepse sipas pikëpamjes asimiluese, është e pranueshme që njerëzit të jenë të ndryshëm, por qëllimi i politikave multikulturore duhet të jetë që grupi i pakicës të bëhet pjesë e grupit të shumicës. Nga kjo nënkuptojmë se multikulturalizmi pranon se njerëzit kanë mënyra të ndryshme të jetesës, shteti nuk duhet t’i asimilojë këto grupe, por t’iu mundësojë dhe të ofrojnë mjetet për të ndjekur mënyrat e tyre të jetesës ose kulturës.

Nga këndvështrimi multikulturor mund të vërejmë se objektivi përfundimtar i politikave nuk është as standardizimi i formave kulturore, as ndonjë formë uniformiteti apo homogjeniteti, përkundrazi, objektivi i tij është të lejojë, mundësojë dhe të jep mjete për grupet e ndryshme për të ndjekur pa pengesa dallimet e tyre.

1.2. Multikulturalizmi në vend dhe në rajon

Edhe pse llogaritet se multikulturalizmi është më tepër koncept amerikan, ai ndërkohë është futur ndjeshëm në shumë shoqëri dhe shtete të botës, madje duke u bërë edhe sistem edukimi që nga nivelet e para të shkollimit të fëmijëve.

Në këtë kontekst, multikulturalizmi është bërë pjesë edhe e shumë shteteve dhe shoqërive evropiane, mu për shkak të diversitetit të theksuar etnik, gjuhësor, racor e religjioz. Prandaj, është zhvilluar edhe një koncept dhe sistem i ri vlerash që quhet multikulturalizmi evropian, për të cilin është punuar shumë që të jetë pjesë e shteteve dhe shoqërive evropiane, e rrjedhimisht edhe ballkanike.

Republika e Maqedonisë së Veriut realisht është një vend multietnik, ku jetojnë një numër i madh i bashkësive të ndryshme etnike, religjioneve e racave. Por, dy komunitetet kryesore me qasje antagoniste ndaj njëra-tjetrës janë maqedonasit dhe shqiptarët. Komunitetet tjera që jetojnë në këtë shtet janë edhe turqit, serbët, vllahët, romët, boshnjakët, etj.

Sipas rezultateve zyrtare të Entit Shtetëror i Statistikës nga regjistrimi i fundit i kryer më 2021, del se „popullsia e përgjithshme rezidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është 1.836.713 persona. Lidhur me strukturën etnike, 58.44% e popullsisë rezidente janë deklaruar maqedonas, 24.30% shqiptarë, 3.86 % turq, 2.53 % romë, 0.47% vllah, 1.30% serbë, dhe 0.87% boshnjak” etj. (<https://popis2021.stat.gov.mk> . Shikuar më 20.07.2022). Enti Shtetëror i Statistikës kishte edhe grafën e regjistrimit sipas përkatësisë fetare, ku mund të themi lirisht se kemi një pluralizëm religjionesh edhe atë: „46.14 % ortodoks, 32.17% myslimanë (islam), 0.37% si katolik, ndërsa në këtë Regjistrim janë paraqitur edhe bashkësi të tjera religjioze të cilët nuk kanë qenë më herët, ata janë: krishterë evangjelistë-protestantë, agnostik, budist dhe të tjerë. Nga popullsia e regjistruar janë deklaruar që gjuha amtare e tyre është: 61.38% gjuha maqedonase, 24.34% gjuha shqipe, 3.41% turke, 1.73% rome, 0.17% vllehe, 0.61% serbe dhe 0.85% boshnjake” (<https://popis2021.stat.gov.mk> . Shikuar më 20.07.2022).

Kurse numri i përgjithshëm i popullsisë së përhershme dhe jo të përhershme është 2.097.319 nga ku: 54.21% maqedonas, 29.52% shqiptarë, 3.98% turq, 2.34% dhe rom, 1.18% serbë, 0.98% boshnjakë dhe 0.44% vllahë. Këtu mund të shohim sa i përket popullsisë jorezidente të cilët kanë emigruar vendeve të jashtme vërejmë se numri i shqiptarëve është gati tre herë më i madh. Maqedonasit si popullsi jorezidente janë 24.45%, shqiptarë jorezidentë janë regjistruar 66.35%, turq 4,79%, romë 1.02%, serbë 0.35%, boshnjakë 0.81% dhe vllahë 0.19%.

Pra, siç shihet kemi të bëjmë me një realitet të vërtetë multietnik në Maqedoninë e Veriut, i cili shtet megjithatë një kohë të gjatë lufton me pasojat e proceseve të tranzicionit të cilat negativisht ndikojnë në jostabilitetin social, ekonomik dhe politik të vendit.

Meqenëse shteti është relativisht i ri, i krijuar në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, ndër vite grupi më i madh etnik maqedonas, ka pasur tendenca të majorizimit të të gjitha grupeve të tjera etnike, religjioze e kulturore, e ku më së shumti kanë pësuar shqiptarët, si grupi më i madh etnik. Kështu, edhe pse historikisht të pranishëm me një përqindje të lartë, shqiptarët nuk kanë pasur të drejtën e shkollimit sipëror, madje edhe pas shkatërrimit të sistemit komunist dhe ardhjes së demokracisë. Pengesa të mëdha patën edhe në shkollimin e mesëm, ku disa herë ka pasur tendenca për mbylljen e shkollave të mesme. Përfaqësimi i tyre në administratën shtetërore dhe në vendimmarrje ishte shumë i ulët. Të gjitha këto padrejtësi diskriminuese ndaj një populli që përbënte më shumë se çerekun e popullsisë së vendit, çuan në pakënaqësi të shumta, të cilat në vitin 2001 kulminuan me një konflikt të hapur ndëretnik, i cili u mbyll me Marrëveshjen e Ohrit, e cila u garantonte shqiptarëve të drejta më të mëdha etnike, kulturore, arsimore, ekonomike, etj. por, megjithatë vlen të theksohet se gjatë asaj periudhe, vendi ka qenë shumë afër shpërbërjes.

Në fillim të qershorit të vitit 2001, kur konflikti në Maqedoni ishte në kulminacion, erdhi një propozim për ndarjen e Maqedonisë në linja etnike. Propozimi ishte bërë nga, ish-kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASHAM), Gjorgji Efremov, sipas të cilit, për t'i dhënë fund mosmarrëveshjeve ndërmjet komuniteteve maqedonase dhe shqiptare, mënyra më e mirë ishte të ndahej Maqedonia në dy entitete. „Sipas këtij plani, shqiptarët do të vendoseshin në rajonet perëndimore të Gostivarit, Tetovës dhe Dibrës, të cilat më pas do të

bashkoheshin me Shqipërinë” (Latifi, 2007:184-185). Më tej Latifi vazhdoi se si sipas Gjorgji Efremovit do të bëhej shkëmbimi „ Shqipëria do t’i jepte Maqedonisë qytetin e Pogradecit dhe zonën përreth pranë Liqenit të Prespës, ku jeton një pakicë e vogël maqedonase. Kryeakademiku kishte propozuar që ky shkëmbim të jetë krejtësisht paqësor dhe të përfundonte brenda tre muajve” (Latifi, 2007:184-185). Fatmirësisht kjo ide nuk gjeti mbështetje më të gjerë të forcat kryesore politike në vend, te kryengritësit shqiptarë dhe te faktori ndërkombëtarë, kështu që dështoi të realizohet në praktikë. Në gusht të vitit 2001, u arrit marrëveshja paqësore mes dy palëve në konflikt, e njohur si Marrëveshja Kornizë e Ohrit.

Pra, kur flitet për atë kohë, kishim të bëjmë me një shtet ku multikulturalizmi kishte ngecur në margjinat e nacionalizmave etnikë dhe assesi nuk po dilte nga ajo gëzhgjë e cila e kishte pllakosur shoqërinë nga krizat e shumta politike, ekonomike, arsimore, kulturore e të ngjashme. Prandaj, në vijë të kësaj problematike, në shekullin e kaluar të viteve 90-ta, u zhvilluan shumë projekte multikulturore në vend, cilat u ndihmuan nga shtetet e Evropës perëndimore dhe SHBA-ja, në mënyrë që koncepti i multikulturalizmit të hyjë në mesin e shoqërisë në mënyrë spontane dhe të kuptohet si një nevojë e domosdoshme për zhvillim të mëtejshëm. Megjithatë, pengesat ishin të shumta dhe ato thujse e pamundësuan një zhvillim të tillë.

Prandaj, ekspertët pajtohen në konstatimin e përgjithshëm se Maqedonia e Veriut e ka problem shtetbërjen, sundimin e ligjit gjithashtu, andaj në këto rrethana nuk ka edhe zhvillim ekonomik. E nëse nuk ka zhvillim ekonomik, nuk ka mobilitet shoqërorë, që do të duhej të arrihet si rezultat i konkurrencës, e cila do të ushtronte presion mbi politikën, që kjo e fundit ta transformojë administratën nga klienteliste në meritokratike. „Kur keni mobilizim të popullatës jo si pasojë e zhvillimit, por si pasojë e varfërisë, është për t’u pritur që në shtetndërtim të dominojë nepotizmi, lojalizimi, lokalizmi dhe, në fund, kemi administratë klienteliste në vend që ajo të jetë profesionale dhe neutrale” (Shaqiri, 2020).

Në bashkësitë multietnike në Republikën e Maqedonisë rrallë gjinden hapësira të përbashkëta për interaksion ndëretnik mes rinjve, hapësira për komunikim të hapur, bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellë dhe respektim i vlerave kulturore dhe mënyrës së të jetuarit. Ndërtimi i hapësirave të përbashkëta alternative për interaksion ndëretnik do të japë kontribut që të

tejkalohen paragjykimet ekzistuese dhe stereotipet, të respektohen dallimet dhe të zhvillohet tolerancë e ndërsjellë mes të rinjve me përkatësi të ndryshme ndëretnike. „Zhvillimi i multikulturalizmit dhe ndërtimi i paqes në bashkësi paraqet sfida dhe interes të përbashkët për të gjithë qytetarët” (Civica & Antico, Shkup, 2010:7).

Ndërtimi i shoqërisë së drejtë demokratike në të cilën do të kenë mundësi dhe të drejta të njëjta, për zhvillim personal dhe përparim, por edhe përgjegjësi për angazhim qytetar në zhvillim të shoqërisë demokratike.

Shpesh pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike, lihen mbrapa proceseve të vendimmarrjes dhe se ato shpesh u nënshtrohen praktikave diskriminuese, pasi në raste të shumta zhvillimi i multikulturalizmit konsiderohet si çështje që prek marrëdhëniet mes pjesëtarëve të komuniteteve dominuese etnike –shqiptarët dhe maqedonasit.

Në vitin 2015, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (SIOFA), në bashkëpunim me OSBE-në dhe Institutin Evropian për Paqe (IEP), përgatiti një analizë për implementimin e MKO-së. Analiza e përfaqësimit adekuat të bashkësive etnike ve në dukje se të gjithë pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, duke përfshirë edhe komunitetin shqiptar, mbeten pamjaftueshëm të përfaqësuar, sidomos në postet udhëheqëse. Krahas kësaj, autorizimet e përdorimit të gjuhës së komuniteteve jo shumicë u panë që nuk vlerësohen në procesin e punësimit dhe kanë qenë të limituara përpjekjet për rritjen e kompetencës gjuhësore të administratës sa i përket kohezionit social në vendin e punës dhe komunikimit me qytetarët. Për sa i përket sferës së arsimit, sipas raportit konkludohet se shkollimi në gjuhën amtare i arsimit fillor dhe atë të mesëm për pjesëtarët e bashkësisë etnike shqiptare dhe turke zbatohet në masë të madhe, por se janë të nevojshme përpjekje shtesë për të përmirësuar situatën e kësaj çështjeje për nxënësit e komuniteteve etnike më të vogla. Ndërsa, segregacioni nëpër shkolla konsiderohet si një ndër problemet më të mëdha me të cilin rrezikohet kohezioni social në sferën e arsimit.

Nga analiza e gjendjes me mirëkuptimin multietnik dhe bashkëjetesën në nëntë komuna të përziera të RMV-së, kanë dal disa konkluzione me shumë interes, si:

1. Në përgjithësi, marrëdhëniet ndëretnike perceptohen si stabile, por ekziston një tendencë evidente midis palëve ku theksohet kontributi i grupit të tyre etnik për ruajtjen e marrëdhënieve paqedashëse në komunë, ndërsa përgjegjësia për segregacionin bartet te grupet tjera etnike;

2. Një nga problemet kyçe në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike paraqitet distanca e theksuar sociale, segregacioni (të jetuarit nëpër lagje “të pastra”) edhe te të rriturit edhe te të rinjtë. Edhe krahas pretendimeve për bashkëpunim dhe komunikim, ishte evidente se komunikimi ekzistues bazohet në pragmatizëm, ndërsa kontaktet në sferën private zakonisht anashkalohen;

3. Një konstatim i papritur nga palët e tanguara është pretendimi se ata i përjetojnë dallimet fetare, si bazë e kufizimit të komunikimit me qytetarët e religjioneve tjera;

4. Barrierat gjuhësore mes qytetarëve me prejardhje etnike të ndryshme;

5. Përfaqësuesit nga sektori i biznesit theksojnë se qytetarët e grupeve të ndryshme etnike shpesh bashkëpunojnë, dhe se kjo është një sferë ku dallimet kulturore kanë më së paku rëndësi. Shumë të anketuar e kanë theksuar gatishmërinë e tyre për të përkrahur aktivitete për zhvillimin e bashkëjetesës multikulturore. (Asociacioni për Iniciativa Demokratike, Gostivar, 2016)

Këto konkluzione janë si rezultat i gjendjes reale që mbretëron në shoqërinë e vendit tonë, ku edhe në këtë kohë ende vazhdojnë paragjykimet ndërmjet komuniteteve etnike apo religjioze. Këtu në masë të madhe vërehen si evidente ndasitë mes tyre në shumë sfera të zhvillimit shoqëror, duke bërë secila kulturë jetën e saj të veçuar nga të tjerat. Në njëfarë mënyre, analiza tërthorazi flet për një dështim të konceptit të multikulturalizmit.

Kështu, duke e parë që në realitet multikulturalizmi si koncept në Maqedoninë e Veriut ishte gati se një mision i pamundur në këto tre dekada të proceseve demokratike, së fundi Qeveria e vendit ka filluar të zbatojë një koncept të ri – interkulturalizmin.

Në tetor të vitit 2018, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi informacionin për nevojën për të hartuar një Strategji kombëtare për zhvillimin e konceptit të një shoqërie dhe interkulturalizmit. Hartimi dhe zbatimi i strategjisë ishte në përputhje me Programin e Qeverisë

dhe me prioritetet strategjike të Qeverisë për vitin 2019. Qëllimi i saj ishte përmirësimi i komunikimit interkulturore mes kulturave dhe bashkësive të ndryshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe përmes saj të zbatohen rekomandimet e trupave ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian si dhe të Organizatës së Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Evropë.

„Strategjia shtetërore për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizmit është dokument që për herë të parë është përgatitur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe vlerësohet të ketë një rëndësi të veçantë duke pasur parasysh ndarjen e shoqërisë sipas bazave të ndryshme”. (Strategjia shtetërore për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizmit, Qeveria e RMV, Shkup, 2019:2). Ky dokument duhet të iniciojë aktivitete dhe të përforcojë proceset e komunikimit dhe bashkëpunimit mes bashkësive drejt krijimit të shoqërisë në të cilën secili ndihet si anëtarë i “një shoqërie”. „Qëllimi kryesor që nga një shoqëri e ndarë, të promovohet si një shoqëri korrekte dhe e drejtë e cila qytetarët i bën më të barabartë dhe të njëjtë, thuhet ndër të tjerash në këtë dokument qeveritar” (Strategjia shtetërore për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizmit, Qeveria e RMV, Shkup, 2019:2).

Interkulturalizmi lidhet me bashkëveprimin e drejtpërdrejt ose ndërmjetësuar ndaj dy ose më shumë grupeve të ndryshme kulturore të çfarëdo madhësie, në çfarëdo niveli të komunikimit të tyre dhe ndikimit të ndërsjellë. „Interkulturalizmi është në kuptim të caktuar reaksion i multikulturalizmit dhe kritika e tij si model që nuk garanton bashkëveprim mes kulturave të ndryshme dhe bashkëveprim të suksesshëm të pjesëtarëve të tyre në shoqërinë multietnike, ndërsa legjitimon ndarjen e bashkësive. Përballë kësaj, interkulturalizmi e promovon konceptin e shkëmbimit dinamik kulturor, dialogut dhe bashkëveprimit mes kulturave të ndryshme” (Standarde për arsim interkulturore, MASH, 2021:6). Në këtë vijë, promovimi i interkulturalizmit në vendin tonë, nënkupton një bashkëveprim më dinamik në mes kulturave të ndryshme (të përfaqësuara nga popullata maqedonase, shqiptare, turke, rome, vllahe, serbe, etj.) që janë të pranishme këtu një kohë shumë të gjatë.

Në masë shumë të madhe interkulturalizmi është qasje nga e cila pritet të tejkalohen disa nga mungesat e multikulturalizmit. „Multikulturalizmi më shumë iu kushtohet parimeve, rregulloreve dhe politikave në një shoqëri shumëkulturëshe me ç’rast pranohet dhe afirmohet ekzistimi i diferencave dhe bashkësive të veçanta, etablohet dhe garantohen të drejtat e tyre (të veçanta), statusi i barabartë dhe mbrojtja përkatëse”. (Kymlicka, ИДЦО, Shkup, 2004). Qëllimi i tij qendror është krijimi i kushteve për bashkekzistencën dhe bashkëpunimin e të gjitha bashkësive të veçanta dhe individëve që u takojnë po atyre, si dhe të stimulimi i mbrojtjes dhe zhvillimit të kulturave të tyre të veçanta.

„Qëllimi kryesor i interkulturalizmit është të mundësojë gërshetimin, bashkëpunimin dhe (bashkë)ekzistencën aktive, duke pasur parasysh se në proceset e tilla kulturat dhe identitetet e veçanta zhvillohen dhe shndërrohen vazhdimisht, si dhe mund të çojnë drejt krijimit të kulturave dhe identiteteve të reja”.(Basic, Zagar, Tatalovic 2018:18-22). Pra, interkulturalizmi determinon krijimin e “vlerave të reja”, krijimin e një “kulture të tretë” e cila do t’i mësojë njerëzit më shumë t’i kultivojnë vlerat e përbashkëta, pa i cenuar kulturat origjinale të çdo identiteti të veçantë. Përparësitë që karakterizojnë këtë qasje janë ndërveprimi dhe dialogu, aspiratat drejt bashkimit dhe kohezioni social i fortë.

E kur jemi te rajoni ynë, rëndomë kemi parasysh Gadishullin e Ballkanit apo gjeografikisht të njohur me termin e ri si Evropë Juglindore. Tani shtrojmë çështjen se si është gjendja me multikulturalizmin në këtë rajon, ku përveç Maqedonisë së Veriut bën pjesë edhe Shqipëria, Kosova, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Bullgaria, etj. Natyrisht që duke qenë një periudhë të gjatë nën sundime të njëjta, siç janë Perandoria Romake, Bizantine apo ajo Osmane, edhe ky rajon paraqet një përzierje të madhe të popujve, religjioneve, racave e kulturave të ndryshme. Rrjedhimisht asnjë nga këto vende nuk është i pastër etnikisht apo kulturalisht, sado që disa prej tyre (p.sh. Greqia, Serbia), në periudha të caktuara historike kanë zhvilluar fushata të vrazhda asimiluese ndaj kulturave tjera. Përkundër të gjitha tendencave për të qenë vende të “pastra” etnikisht dhe kulturalisht, asnjëra nga to nuk ia ka arritur qëllimit, dhe tani vazhdojnë të funksionojnë si shoqëri të përziera, ku rëndomë njëra kulturë është kryesore – mbizotëruese ndaj kulturave tjera.

Faktikisht, Ballkani paraqet një konglomerat kulturash të ndryshme etnike, religjioze, racore, etj., dhe një shembull tipik të një hapësire multikulturore, me mjaft shembuj negativ, por edhe pozitiv të bashkëjetesës. Siç dihet, këtu jetojnë bullgarë, maqedonas, serbë, malazezë, kroatë, boshnjakë, shqiptarë, grekë. Jetojnë myslimanë sunitë e shiitë, ortodoksë, katolikë, protestantë, hebrenj, edhe njerëz të racave të ndryshme.

Nëse e shikojmë problemin në rrafshin historik, e gjithë historia e Ballkanit është e përshkruar me konflikte, tensione dhe luftëra të vazhdueshme mes popujve, kryesisht me qëllime ekspansioniste, pra për zgjerime territoriale. Prandaj, është krijuar një bindje e përgjithshme se modeli i multikulturalizmit në shoqëritë ballkanike ka funksionuar për mrekulli brenda popujve dhe feve të ndryshme, derisa nuk është përzier politika, e cila ka shkatërruar gjithçka që me shekuj kishin ndërtuar njerëzit e zakonshëm. Shembujt konkret janë të shumtë, por me këtë rast po përmendim periudhën më të re që është më e freskët, kur politika nacionaliste serbe në ish-Jugosllavi, ishte shkaktare direkte e gjakderdhjeve të tmerrshme brenda komuniteteve të ndryshme etnike.

Shkëmbimi i detyruar i popullsisë e prek në mënyrë të thellë fenomenin minoritar. Kjo zgjidhje ka qenë konceptuar historikisht nga shtetet ballkanike të nesërmen e luftërave me qëllim të konsolidonin hapësirën kombëtare dhe t'i bënin etnikisht homogjene shtetet respektive. Dëbimi i minoriteteve është prova më e qartë e paaftësisë së shoqërive multikulturore për të toleruar diversitetin. Në historinë e gjatë të Evropës, dëbimet dhe zhvendosjet e popullsisë kanë ndodhur me synimin e spastrimit etnik. Nuk duhet ende të harrojmë se praktika të tilla janë zbatuar edhe në kohët tona nga disa shtete ballkanike kundrejt popujve të tyre (De Rapper, Sintès, Kaurinkoski 2015:139).

Në një aspekt tjetër, nëse e shikojmë se sa respektohen vlerat multikulturore në secilin shtet tjetër të Ballkanit veç e veç, atëherë s'do mend se shumë pak prej tyre janë për lëvdata, për të mos thënë aspak, me përjashtim të Republikës së Kosovës. Vetëm Kosova, si shteti më i ri në Ballkan, përbën shembullin më pozitiv për respektimin e vlerave multikulturore. Aty edhe pse shqiptarët përbëjnë mbi 90% të popullsisë, të gjithë popujt tjerë i kanë të drejtat e tyre kombëtare, gjuhësore, religjioze, kulturore e arsimore. Madje, serbët që përbëjnë më pak se 7%

të popullsisë, i gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre, ndërsa gjuha serbe është edhe gjuhë zyrtare shtetërore. Fatkeqësisht, këto standarde të larta multikulturaliste, ende nuk i gëzojnë shqiptarët që jetojnë në vise tjera të rajonit ballkanik, si në Serbi, Mal të Zi apo deri para pak kohësh edhe në Maqedoninë e Veriut. Shembulli i Republikës së Kosovës me politikat gjuhësore dhe multikulturore, është mirë të ndiqet edhe nga vendet tjera të rajonit, për të garantuar paqe dhe stabilitet afatgjatë në rajon.

1.3. Multikulturalizmi në sistemin ndërkombëtar

Bota moderne karakterizohet nga tendenca të vazhdueshme multikulturore, prandaj ndërgjegjësimi për diversitetin në planin ndërkombëtar dhe ndërkulturor ka një rëndësi të madhe. Bota po globalizohet gjithnjë e më tepër, kombet janë në rritje të ndërvarësisë ekonomike, shkencore, kulturore dhe politike. Këto procese globalizuese ndërkombëtare vazhdimisht fitojnë avantazh në raport me tendencat e separatizmit dhe ndarjeve kulturore.

Diversiteti kulturor lidhet me praktika të ndryshme jetësore të individëve sipas kombësisë, besimit, gjinisë, moshës, aftësive fizike dhe orientimit seksual. Përkrahja e konceptit të diversitetit kulturor në një shoqëri, do të thotë t'i shohësh njerëzit si individë, duke pranuar të veçantat e tyre, dhe duke marrë në konsideratë të drejtat individuale dhe dinjitetin e tyre.

Historikisht, Evropa ka qenë gjithmonë një përzierje e kulturave të ndryshme, si ato: latine, bizantine, osmane, sllave, urale, kelte, helene, ilire, trake dhe të tjera, me sisteme të ndryshme besimi. Edhe pse ideologjia e multikulturalizmit është e re, shoqëritë multikulturore janë të lashta. Më vitin 1970, Kryeministri Kanadez Pierre Trudeau gjatë postit të tij implementoi multikulturalizmin (një shoqëri e drejtë) si mjet të qeverisjes politike. Ishte një përgjigje pragmatike ndaj pretendimeve për të drejtat e 'kombeve të mëdha' dhe separatizmit në rritje midis franko-kanadezëve/kebekoit. Më pas ai koncept u zbatua edhe në kontekstet që përfshinin emigrantët. Në Kanada, ideologjia e multikulturalizmit pasqyrohet në ligj nëpërmjet

Aktit Kanadez të Multikulturalizmit dhe seksionit 27 të Kartës Kanadeze të të Drejtave dhe Lirive. Vende të tjera, të tilla si SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Australia, ndoqën qasjen e Kanadasë dhe përshtatën politikat multikulturore nëpër vendet e tyre, si rezultat i migrimit masiv. Australia ishte vendi i dytë pas Kanadasë që miratoi një politikë zyrtare të multikulturalizmit. Politika e 'Australisë së Bardhë' u shpërbë pas Luftës së Dytë Botërore nga ndryshimet e mëdha që shkaktoi imigrimi politik, ndërsa multikulturalizmi filloi të zbatohet nga viti 1972, ndërsa në vitin 2020, pothuajse çdo vend në mbarë botën përfaqësonte popullsinë e australiane.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, metafora e 'kazanit të shkrirjes' nënkuptonte që çdo emigrant duhet të asimilohet në shoqërinë amerikane me ritmin e tij. Në mënyrë të ngjashme, në Mbretërinë e Bashkuar, imigracioni pas Luftës së Dytë Botërore formësoi fytyrën e lagjeve britanike. Emigrantët sollën kulturën e tyre me vete dhe u asimiluan në kulturën britanike. Qeveritë në Suedi dhe Holandë miratuan gjithashtu politika të multikulturalizmit në vitet e 70-ta dhe '80-ta të shekullit të kaluar. Ndërsa sot, shumë shoqëri në mbarë botën janë të ndryshme kulturalisht (Përmbledhje e shkurtër e multikulturalizmit në mbarë botën: <https://www.yoair.com/sq/blog/anthropology-brief-overview-of-multiculturalism-around-the-world/>. Shikuar më 28.07. 2022).

Shumë imazhe ikonike të jetës së emigrantit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të tilla si masat e grumbulluara të njerëzve që presin në Ellis Island, ose anijet që kalojnë Statujën e Lirisë me pasagjerë të etur e të uritur, ishin të falsifikuara. Gjatë asaj periudhe termi "tenxhere shkrirjeje" u shpik si një metaforë për përshkrimin e procesit me të cilin emigrantët e ardhur duhej të zhyteshin (shkriheshin) në shoqërinë kryesore amerikane. Kjo metaforë ende rezonon thellësisht edhe me amerikanët e sotëm. Pika më dalluese për këtë version të kazanit të shkrirjes është se vlerat anglosaksone në zemër të identitetit amerikan mendohet të jenë padyshim superiore ndaj ndonjë prej traditave të sjella ose të mbajtura nga emigrantë të tjerë. (Orosco, 2016:1, 13-14). Kështu, rezulton që një nga temat më të zakonshme në mesin e shoqërisë anglo-saksone amerikane, ishte që emigrantët të cilët mbërrinin në ShBA asokohe

ishin një kërcënim serioz për homogjenitetin etnik të vendit, dhe për rrjedhojë, rrezik edhe ndaj qytetarisë dhe vetë shtetit të ri amerikan.

Në të vërtetë, termi multikulturalizëm hyri në gjuhën e zakonshme të shumë vendeve perëndimore në vitet 1980 dhe 1990, kur valët e reja të migrantëve dhe pakicave etnike kishin filluar t'i artikulojnë dëshirat e tyre për njohje të plotë dhe inkorporim brenda shoqërive në të cilat ishin vendosur.

Multikulturalizmi fillimisht diskutohet si prania themelore e diversitetit kulturor në një shoqëri. Më pas paraqitet si një orientim në politikat publike drejt këtij diversiteti. Dallohet nga pluralizmi (ku ka vetëm diversitet) duke vënë në dukje se politika dhe praktika e multikulturalizmit ka dy bërthama të veçanta: përveç pranisë së diversitetit kulturor, multikulturalizmi kërkon edhe kontaktin ndërkulturor dhe pjesëmarrjen e barabartë e të gjithë elementëve kulturorë në jetën e shoqërisë më të madhe, që nganjëherë është referuar si ndërkulturalizëm ose interkulturalizëm.

Dallimet në kuptimin e identiteteve kombëtare ka të ngjarë të jenë të lidhura ngushtë me politikat kombëtare drejt diversitetit kulturor. Vendet ndryshojnë në shkallën në të cilën ata janë të orientuar drejt multikulturalizmit (inkurajimi i emigrantëve për të festuar dhe të qëndrojnë besnikë ndaj trashëgimisë së tyre kulturore) kundrejt asimilimit (inkurajimi i migrantëve për të adoptuar mënyrat dhe mjetet e vendit të vendbanim). (Martínez, Hong, 2014: 72-73). Për shembull, brenda Amerikës së Veriut, shteti kanadez ka miratuar një politikë multikulturore në të cilën shumica e emigrantëve shihen si pasurim i diversitetit të vendit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ana tjetër, janë shtëpia e fraksioneve kundërshtare - një grup liberal që beson në shfaqjen e diversitetit, dhe një grup konservator që e sheh vendin me rrënjët e saj evropiane, ndërsa valën aktuale të emigrantëve sidomos hispanikë e aziatikë, i shesh si një kërcënim për kulturën amerikane.

Në sociologji, "kazani i shkrirjes" është një koncept që i referohet një shoqërie heterogjene që bëhet më homogjene me elementët e ndryshëm që "shkrihen së bashku" në një tërësi harmonike me një kulturë të përbashkët. (Greelane:Çfarë është „ Pot shkrirja amerikane”? <https://www.greelane.com/sq/shkencë-teknikë-matematikë/shkencat-shoqërore/melting-pot-definition->. shikuar më 25.07.2022). “Kazani i shkrirjes” si koncept në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përdoret për të përshkruar asimilimin e emigrantëve, megjithëse mund të përdoret në çdo kontekst ku një kulturë e re fillon të bashkëjetojë me një tjetër. Në kohët e fundit, refugjatët nga Lindja e Mesme kanë krijuar një lloj vazo shkrirjeje në të gjithë kontinentin evropian dhe atë amerikan. Megjithatë, ky term shpesh sfidohet nga ata që pohojnë se dallimet kulturore brenda një shoqërie janë të vlefshme dhe duhet të ruhen. Një metaforë alternative, e konceptit të “kazanit të shkrirjes” është koncepti i “tasit të sallatës” (ose “mozaiku i sallatës”), që nënkupton procesin kur kulturat e ndryshme përzihen, por megjithatë ato ende mbeten të dallueshme. Shtetet e Bashkuara të Amerikës u themeluan mbi konceptin e mundësisë për çdo emigrant, dhe sot e kësaj dite kjo e drejtë për të emigruar në SHBA mbrohet në gjykatat e saj më të larta. Termi filloi fillimisht në SHBA rreth vitit 1788 për të përshkruar kulturat e shumë kombësive evropiane, aziatike dhe afrikane të bashkuara së bashku në kulturën e sapogjetur të Shteteve të Bashkuara të reja. „Kjo ide e shkrirjes së kulturave së bashku zgjati në pjesën më të madhe të shekujve XIX dhe XX, duke kulmuar në shfaqjen e vitit 1908 "The Melting Pot", e cila përjetësoi më tej idealin amerikan të një shoqërie homogjene të shumë kulturave”. (<https://www.greelane.com/sq/shkencë-teknikë-matematikë/shkencat-shoqërore/melting-pot-definition->. shikuar më 25.07.2022).

Kur metafora e kazanit të shkrirjes fillimisht hyri në fjalorin kombëtar amerikan në vitin 1908, disa filozofë amerikanë e kritikuan. Ata nuk e bënë atë me synimin për ta hedhur poshtë plotësisht këtë ide, por me shpresën për të mbrojtur konceptin themelor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si një demokraci pluraliste kulturore e cila po varrosej brenda saj (Orosco, 2016:3). Megjithatë, ndërsa bota u tejkalua në luftën globale në vitet 1910, 1920 dhe përsëri në vitet 1930 dhe 1940, amerikanët filluan të krijojnë një qasje anti-globaliste ndaj vlerave amerikane dhe një kontigjent i madh qytetarësh filluan të bëjnë thirrje për ndalimin e emigrantëve nga disa vende të bazuara në kulturat dhe fetë e tyre.

Në të vërtetë, multikulturalizmi në sistemin ndërkombëtar në masë të madhe ka pasur pikërisht efektin metaforik që ishte krijuar shumë më parë, ndoshta, siç cekëm më lartë, edhe me vetë krijimin e shtetit amerikan. Pra, përmes forcimit të demokracisë liberale dhe shtetit të fortë e të sigurt ekonomikisht dhe politikisht, kishte arritur të përfitojë një numër shumë të madh migrantësh nga e mbarë bota, dhe duke iu adaptuar ligjeve dhe zakoneve të reja në vendin mikpritës, kishin marrë shumëçka nga shoqëria dominante amerikane, dhe dalëngadalë ishin bërë pjesë integrale e saj, duke humbur në masë të madhe veçoritë e tyre identitare, pra të vendit të origjinës.

Megjithatë, shtetet e botës perëndimore që kanë pranuar migrantë, sidomos nga vendet e lindjes, shpeshherë janë përballuar me probleme të mëdha në procesin e integritimit dhe socializimit të tyre. Jogjithherë të posaçdhurit kanë qenë njerëz të socializuar, të sjellshëm dhe paqedashës me rrethin e ri. Prandaj, ka qenë një periudhë dhe proces relativisht i gjatë i adaptimit të tyre në shoqëritë e reja, me ligje dhe kode të reja të sjelljes që diktonin vendet mikpritëse. Prandaj, shpeshherë na bie të jemi dëshmitarë të akteve të dhunës që shkaktohen nga emigrantë, të cilët nuk kanë arritur të sistemohen dhe adaptohen siç duhet brenda shoqërive mikpritëse.

Problemet shpesh lidhen me emigrantët e brezit të dytë apo të tretë në shoqëritë e Evropës Perëndimore, pikërisht ata që duhet të integroheshin si anëtarë të barabartë të atyre shoqërive rebelohen ndaj vendeve që i kanë birësuar. „Arsyet që paraqiten shpesh janë varfëria (2/3 e myslimanëve anglezë janë nga familjet me të ardhura të ulëta), banesat e papërshtatshme, mbipopullimi, getoizimi, papunësia sidomos ndër të rinjtë, mungesa e arsimit dhe paragjykimet racore të fqinjëve jo myslimanë”. (Walter Laqueur, Last days of Europe – Epitaph for an Old Continent <https://8mvsk.wordpress.com/2016/11/10/multikulturalizmi-ne-evrope/>. Shikuar më 23.07.2022). Thuhet se të gjitha këto çojnë në mungesë të lëvizshmërisë sociale, kriminalitet dhe përgjithësisht në diskriminimin e komuniteteve myslimane. Tërthorazi apo drejtpërsëdrejti pohohet se për këtë gjendje fajtor është shteti dhe shoqëria!? Por myslimanët që kanë pasur sukses në sipërmarrje apo në profesionet e tyre thonë, pothuajse të gjithë pa përjashtim, që identiteti i tyre etnik nuk ka qenë asnjëherë pengesë në rrugën drejt suksesit.

Sidoqoftë, është fakt i pamohueshëm se diversiteti dhe multikulturalizmi në sistemin ndërkombëtar, janë bërë pjesë përbërëse e shumë shteteve dhe shoqërive, duke krijuar premisa të një zhvillimi të ri të hovshëm kulturor, arsimor, ekonomik dhe politik. Qoftë përmes kushtetutave ose ligjeve tjera ndërkombëtare, respektimi i vlerave multikulturore u bë standard ndërkombëtar i botës së zhvilluar perëndimore.

2. PJESA E DYTË

2.1. Multikulturalizmi si model i ri lehtësues në tejkalimin e paragjytimeve brenda komuniteteve - parë në prizmin e anketave

Kuptimi dhe trajtimi i duhur i vlerave multikulturore që kanë shoqëritë tona, është i një rëndësie të veçantë për tejkalimin e paragjytimeve të ndryshme etnike, gjuhësore, racore e të ngjashme që ende vazhdojnë të jenë brenda komuniteteve tona. Kultivimi i duhur dhe në vendin e duhur i vlerave multikulturore, paraqet model të jashtëzakonshëm lehtësues në zgjidhjen e shumë problemeve të natyrave etnike, që janë nga më të shpeshtat në Ballkan, dhe specifikisht edhe në vendin tonë – Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Fatkeqësisht, deri më sot s'është bërë mjaftueshëm në zbatimin e modeleve multikulturore që shërbejnë për një paqësim në vendin tonë dhe të rajonit në përgjithësi. Për këtë edhe vetë personalisht jemi bindur gjatë pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në zhvillimin e një projekti multikulturore në rajonin e Kumanovës, me nxënës të përkatësive të ndryshme etno-kulturore (Shih – Anketën e parë). Por, më pas realizuam edhe vetë një anketë anonime me maturantë dhe studentë të rajonave të ndryshme etno-kulturore të mbarë Maqedonisë së Veriut (Shih – Anketa e dytë).

Në projektin e parë ishte paraparë që të realizohen disa punëtori të përbashkëta me nxënësit e shkollave të mesme, me nxënës të etnive e religjioneve të ndryshme, dhe hapi i parë që morëm ishte një takim paraprak me nxënësit e shkollave të mesme në Komunën e Kumanovës dhe Likovës. Projektin e prezantuam nëpër të gjitha shkollat e mesme dhe hasëm në mirëkuptim nga drejtorët e shkollave. Poashtu nga drejtorët e këtyre shkollave kërkuam që nga çdo klasë që nga viti i parë deri te viti i katërt të na sigurojnë nga 3-5 nxënës (me lejen e prindërve të tyre). Projekti ishte paraparë që të zgjasë gjashtë muaj, dhe arritëm të sigurojmë për anketim gjithsej 310 nxënës nga pesë shkolla të mesme, edhet atë: dy shkolla të mesme me mësim në gjuhën

shqipe dhe tri shkolla të mesme me mësim në gjuhën maqedonase. Fillimisht takimet me nxënësit i realizuam ndaras, që të shohim dhe prekim pulsën e tyre për një bashkëpunim me nxënës të etnive tjera. Po me këta nxënës bëmë edhe një anketë që të marrim opinionin e tyre para se të marrin pjesë në punëtori të ndryshme gjatë realizimit të projektit, ndërsa realizuam edhe një anketë pas mbarimit të projektit.

Rezultatet që morëm në këto anketa ishin shumë interesante, dhe ato do t'i prezantojmë më poshtë në mënyrë më të detajuar dhe tabelare.

Anketa e parë:

Tabela 1. Prezantimi i të anketuarve në lidhje me gjininë, nëpër shkollat e mesme:

Gjinia	Meshkuj	Femra	Në total
Numri i të anketuarve	124	186	310
Përqindja	40%	60%	100%

Në tabelën 1, së pari shohim një dallim të madh ndërmjet të anketuarve për sa i përket gjinisë. Në numrin e përgjithshëm të të anketuarve (gjithsej 310), kishte 124 nxënës meshkuj dhe 186 nxënës femra. Domethënë, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve që kanë marrë pjesë, 40% ishin meshkuj, dhe vetëm 60% ishin femra.

Tabela 2. Kontakti/miqësia me njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike:

Kontakti/miqësia me njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore /etnike	Nuk kam asnjë kontakt	Po, nga një vend tjetër	Po, nga 2 vende tjera	Po, nga 3 vende tjera	Po, nga më shumë se 3 vende tjera	Në total
Nr (%)	107 (34,52%)	66 (21,29%)	54 (17,42%)	15 (4,84%)	68 (21,93%)	310

Kam miq nga vende të ndryshme me prejardhje të ndryshme kulturore /etnike se e imja	nuk kam	1	2	3	4	5 apo më shumë
Nr (%)	90 (29.03%)	87 (28.06%)	49 (15.81%)	42 (13.55%)	32 (10.32%)	10 (3.23%)

Në tabelën 2, ne kemi një shfaqje të shpeshtësisë së kontakteve dhe miqësive me njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike. Më shumë se 1/3 e të anketuarve nuk kanë kontakte me njerëz të vendeve tjera ose me origjinë të ndryshme etnike, 29.03.52% e tyre nuk kanë miq me përkatësi kulturore/etnike të ndryshme. Kurse 28.06% e të anketuarve janë në kontakt me një vend, 15.81% me dy vende, 13.55% me tre vende, 10.32% me katër vende, dhe krejt në fund 3.23 me 5 apo më tepër vende.

Tabela 3. Miqësia, bashkëpunimi, shkollimi me njerëz me kultura dhe etni të ndryshme:

Dua të bëj miqësi me një person / persona me prejardhje të ndryshme kulturore / etnike	Po	Jo	Nuk e di
(%)	104 (33.55%)	177 (57.10%)	29 (9,35%)
Dua të studioj / punoj / bashkëpunoj me njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore / etnike	Po	Jo	Nuk e di
(%)	104 (33.55%)	177 (57.10%)	29 (9,35%)

Sipas kësaj tablele (3), është evidente se pothuajse 90.65% e nxënësve nuk ishin të gatshëm dhe nuk dëshironin të krijojnë miqësi me një person me prejardhje të ndryshme kulturore, etnike, dhe vetëm 9.35% e tyre nuk u deklaruan as “po” e as “jo”, duke u përgjigjur me “nuk e di”. Në të njëjtën tabelë, shohim të njëjtën pasqyrë të të anketuarve që nuk dëshironin të studiojnë, punojnë apo bashkëpunojnë me njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore, etnike!

Këto ishin rezultatet e anketave para se të fillonim me realizimin e projektit, e që për ne këto shifra ishin mjaft alarmuese.

Hapi i parë që morëm ishte që këta nxënës të ndahen në dy grupe me nga 155 nxënës, dhe çdo grup të jetë i përzier proporcionalisht nga të gjitha etnitë, religjionet, kulturat, etj., duke qenë rajoni ynë në bërthamë vend multikulturor, edhe pjesëmarrësit në projekt, pra nxënësit ishin të përkatësisë etnike: maqedonase, shqiptare, serbe, rome, turke, etj., të cilët në vetvete ngërthejnë edhe religjione të ndryshme. Grupi i parë do të vinin javën e parë dhe të tretë të muajit, ndërsa grupi i dytë do të vinin në javën e dytë dhe të katërt të muajit. Grupi i parë me 155 nxënës do të ndaheshin me 5 për çdo ditë të javës, domethënë nga 31 nxënës, nga të cilët 15 paradite dhe 16 pasdite, varësisht se në çfarë ndërrimi të shkollës ishin. Kështuqë me secilin grup mund të punonim në punëtori dy herë në muaj. Punëtoritë zhvilloheshin në dy gjuhë: maqedonisht dhe shqip, me përkthyes. Ditët e para në punëtori ishin të parapara që çdo kush të fliste për traditat kombëtare dhe religjioze si dhe për festat kombëtare, fetare si dhe ato familjare. Punëtoritë ishin të menduara ashtu që për çdo ditë të ketë nga një risi, duke filluar me poezi, këngë, lojëra të ndryshme, deri tek ajo përfundimtarja, që çdo kush të prezantojë shokun tjetër me një poezi apo pikturë nga traditat e tyre.

Ishte shumë interesant fakti se që nga java e tretë e punëtorisë, fillimisht nxënëset vajza, filluan t'i shkëmbejnë numrat e telefonit mes vete, dhe në mbrëmje filluan të dalin së bashku nëpër kafeteri! Barrierat gjuhësore i tejkaluan duke filluar që mes vete të flisnin në gjuhën angleze. Po ashtu këtë hap e morën edhe meshkujt, edhe pse pak më vonë, por shkuan deri atje sa të ftonin njëri - tjetrin nëpër shtëpitë e tyre që të njihen më për së afërmi mes veti dhe me familjarët.

Më tej, gjatë punëtorisë organizuam edhe vizita nëpër objektet fetare, siç xhamitë, kishat, tyrbet, varrezat, monumentet e ndryshme historike, takime me klerikët fetarë të dyja konfesioneve, islame, krishtere, etj. Në fund të projektit, të gjitha poezitë që ishin recituar, pikturat që ishin pikturuar, njëri - tjetrit ia dhuruan të nënshkruara dhe me përkushtim “shokut tim”.

Në fund të projektit, para se të ndaheshim, ua dhamë të njëjtën listë anketuese të gjithë nxënësve që ua patëm dhënë disa muaj më parë. Dhe, rezultatet ishin befasuese!

Tabela 4. Kontakti, miqësia me njerëz të kulturave dhe etnive të ndryshme :

Kontakti / miqësia	Nuk kam asnjë kontakt	Po, nga një vend tjetër	Po, nga 2 vende tjera	Po, nga 3 vende tjera	Po, nga më shumë se 3 vende tjera	Në total
nr (%)	/	278 (89.68%)	27 (8.71%)	3 (0.97%)	2 (0.64%)	310 (100%)
Kam miq nga vendet tjera me prejardhje të ndryshme kulturore / etnike nga e imja	nuk kam miq	Po, nga një vend tjetër	Po, nga 2 vende tjera	Po, nga 3 vende tjera	Po, nga më shumë se 3 vende tjera	Në total
nr (%)	/	278 (89.68%)	27 (8.71%)	3 (0.97%)	2 (0.64%)	310 (100%)

Pra siç shihet nga anketa, në një interval gjashtëmuor, pas një ndërkomunikimi dhe ndërveprimi të arsyeshëm në mes të rinjve nga komunitetet e ndryshme etnike e religjioze, rezultatet gati se u përmbysën. Tani në vend të përgjigjeve negative nëse kanë miq apo brenda njerëzve me prejardhje të ndryshme etnike, pas gjashtë muajve ato përgjigje janë të gjitha pozitive.

Tabela 5. Krijimi i një përvoje multikulturore:

	Asnjëherë (%)	Rrallë (%)	Ndonjëherë (%)	Shpesh (%)	Gjithmonë (%)
Mundohem të dëgjoj / lexoj / kuptoj këndvështrime të ndryshme nga të miat	1 (0,33%)	3 (0.97%)	17 (5,48%)	75 (24,19%)	214 (69,03%)

Mundohem të takoj njerëz që janë të ndryshëm nga unë	3 (0,97%)	5 (1,61%)	40 (12,9%)	81 (26,13%)	181 (58,39%)
Mundohem të jem i vetëdijshëm për paragjykimet e mia	3 (0,97%)	3 (0,97%)	27 (8,71%)	78 (25,16%)	199 (64,19%)
Po mendoj për problemet e diskriminimit, racizmit, shtypjes etj.	4 (1,29%)	19 (6,13%)	50 (16,13%)	92 (29,68%)	145 (46,77%)

Tabela 5 tregon rezultatet me përvojën e dëshiruar dhe të arritur multikulturore në një mjedis të vërtetë multikulturor, siç është rajonin i Kumanovës. Pra, siç shihet, një numër i madh i të anketuarve (214), deklaruan se përpiqen gjithmonë të dëgjojnë, lexojnë e kuptojnë këndvështrime të ndryshme nga ato të tyre, që është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një përvoje të duhur multikulturore në mesin e nxënësve.

Ky projekt na bën me dije se sa është i rëndësishëm komunikimi në mes komuniteteve të ndryshme në mjedis multikulturor, dhe sa është e rëndësishme njohja e përafërt në mes vete për njohjen e tjetrit nga afër ashtu siç është, pa paragjykime të llojeve të ndryshme. Pra, në një ambient të përzier multikulturor, ku me vite dhe dekada të tëra janë ushqyer mosdurime etnike e fetare, duke rezultuar edhe me konflikt të armatosur (viti 2001), përmes një komunikimi dhe njohjeje të sigurtë mes të rinjve me etni, gjuhë e fe të ndryshme, janë arritur rezultate të shkëlqyera.

Kjo na bën me dije se sa ka nevojë shoqëria jonë ta njohë nga afër njëri-tjetrin, tejkalimin e dallimeve, për zhvillim më normal të një shoqërie bashkëkohore, për jetesë në paqe e normalitet përkaj diversitetit të theksuar objektiv që mbisundon në të gjitha sferat.

Anketa e dytë:

Pasi që në metodologjinë e hulumtimit shkencor, metoda krahasuese është e pranueshme dhe mjaft e zbatueshme nëpër problematika shoqërore siç është edhe kjo e jona, vendosa të bëj krahasimin e anketës së parë me një të dytë. Anketat janë zhvilluar në periudha të ndryshme kohore, por fatkeqësisht rezultatet nuk janë aq të lakmueshme as në anketën e dytë.

Kështu, gjatë periudhës së vjeshtës së vitit 2022, realizuam një anketë tjetër të drejtpërdrejtë me gjithsej 704 qytetarë të përkatësive të ndryshme etnike të Maqedonisë së Veriut, kryesisht të rinj – maturanë të shkollave të mesme dhe studentë (maqedonas, shqiptarë dhe të tjerë), nëpër qytete të ndryshme të vendit dhe me gjini të ndryshme, sipas grafikonit të mëposhtëm:

Qyteti	nr. anketave	Femra	Meshkuj	Përkatësia etnike sipas gjinisë			
				F. shqiptare	F. maqed.	M. shqiptarë	M. maqed.
Kumanovë	50	27	23	14	13	12	11
Shkup	70	39	31	22	17	18	13
Tetovë	50	32	18	21	11	13	5
Gostivar	50	19	31	13	6	22	9
Kërçovë	50	15	35	11	4	19	16
Strugë	50	34	16	21	13	12	4
Ohër	50	27	23	6	21	3	20
Manastir	40	22	18	2	20	3	15
Strumicë	50	18	32	/	18	/	32
Prilep	40	21	19	/	21	/	19
Veles	35	16	19	/	16	2	17
Kr.Pallankë	30	14	16	/	14	/	16
Sh. Nikolla	35	22	13	/	22	/	13
Shtip	40	29	11	/	29	/	11
Koçanë	31	14	17	/	14	/	17
Kratovë	33	8	25	/	8	/	25
Totali	704	357	347	110	247	104	243

		(50.71%)	(49.29%)	(15.62%)	(35.08%)	(14.77%)	(34.51%)
Totali sipas përkatësisë: shqiptarë 30.39%, maqedonas 69.60%							

Përgjigjet sipas përkatësisë etnike	Shqiptarë	Maqedonas	Totali
Çfarë mendimi keni për multikulturalizmin?	214 (30.39%)	490 (69.60%)	704
Pozitiv	167 (23.72%)	354 (50.28%)	521 (74%)
Negativ	32 (4.54%)	80 (11.36%)	112 (16%)
Nuk e di	15 (2.13%)	56 (7.95%)	71(10%)
A mendoni se funksionon multikulturalizmi?			
Po	13 (1.84%)	138(19.60%)	151 (21%)
Jo	175 (24.85%)	322 (45.73%)	497 (71%)
Nuk e di	26 (3.69%)	30 (4.26%)	56 (8%)
A është multikulturalizmi në të mirën e shoqërisë?			
Po	167 (23.72%)	354 (50.28%)	521 (74%)
Jo	32 (4.54%)	80 (11.36%)	112 (16%)
Nuk e di	15 (2.13%)	56 (7.95%)	71 (10%)
Funksionimi i multikulturalizmit a i rrezikon etnitë tjera?			
Po	32 (4.54%)	80 (11.36%)	112 (16%)
Jo	167 (23.72%)	354 (50.28%)	521 (74%)
Nuk e di	15 (2.13%)	56 (7.95%)	71 (10%)
A keni ndonjë shok me prejardhje ndryshme kulturore/etnike?			
Po	214 (30.39%)	283(40.19%)	497 (71%)
Jo	/	151 (21.44%)	151 (21%)
Nuk e di	/	56 (7.95%)	56 (8%)
A dëshironi të keni shok me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike?			
Po	214 (30.39%)	283(40.19%)	497 (71%)
Jo	/	151 (21.44%)	151 (21%)

Nuk e di	/	56 (7.95%)	56 (8%)
Sa shpesh shiheni/shoqëroheni me shokun tuaj me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike?			
Një here në javë	96 (13.63%)	57 (8.09%)	153 (22%)
Një here në muaj	72 (10.22%)	93 (13.21%)	165 (24%)
Më rrallë se një here në muaj	46 (6.53%)	133 (18.89%)	179(25%)
Nuk takohemi	/	207 (29.40%)	207 (29%)
Si i vlerësoni marrëdhëniet ndëretnike në komunën tuaj?			
Positive	146 (20.73%)	269 (38.21%)	415 (59%)
Negative	48 (6.81%)	189 (26.84%)	237 (34%)
Nuk e di	20 (2.84%)	32 (4.54%)	52 (7%)
A do të martoheshit me një person i cili është me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike?			
Po	114 (16.19%)	245 (34.80%)	359 (51%)
Jo	87 (12.35%)	192 (27.27%)	279 (40%)
Nuk e di	13 (1.84%)	53 (7.52%)	66 (9%)
A jeni të interesuar për të mësuar për komunitetet tjera dhe kulturat e tyre?			
Po	214 (30.39%)	283(40.19%)	497 (71%)
Jo	/	151 (21.44%)	151 (21%)
Nuk e di	/	56 (7.95%)	56 (8%)
Në komunën tuaj a është organizuar ndonjë ngjarje multikulturore?			
Po	32 (4.54%)	80 (11.36%)	112 (16 %)
Jo	167 (23.72%)	354 (50.28%)	521 (74%)
Nuk e di	15 (2.19%)	56 (7.95%)	71 (10%)

Tabela 1. Prezantimi i të anketuarve në lidhje me gjininë:

Gjinia	Meshkuj	Femra	Në total
--------	---------	-------	----------

Numri i të anketuarve	347	357	704
Përqindja	49.29%	50.71%	100%

Në tabelën 1, nuk shohim ndonjë dallim të madh ndërmjet të anketuarve për sa i përket gjinisë. Në numrin e përgjithshëm të të anketuarve (704), kishte 357 femra dhe 347 meshkuj. Domethënë, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve që kanë marrë pjesë në anketë, 50.71% ishin femra, dhe 49.29% ishin meshkuj.

Tabela 2. Paraqitja e të anketuarve sipas moshës:

Mosha	18-24	25-34	35-44	45-54	55 - 64
Numri i të anketuarve	149	86	93	211	165
Përqindja	21.16%	12.21%	13.21%	29.97%	23.43%

Në tabelën 2, kur bëhet fjalë për moshën e të anketuarve, ku 149 janë të moshës 18-24 vjeç, 86 janë të moshës nga 25-34 vjeç, 93 janë të moshës nga 35-44, 211 janë të moshës nga 45-54, 165 janë të moshës 55-64 vjeç. Shohim se numri më i madh i të anketuarve është nga mosha 45 deri më 64 vjeç dhe në total është 376, kurse nga mosha 25-44 kemi 179 të anketuar dhe 149 kemi nga mosha 18-24 vjeç. Këtu shohim se mërgimi po merr haraçin e vet, meqë 376 e të anketuarve janë mbi moshën 45 vjeç, kurse numri më i vogël është nga mosha 25-34 vjeç, moshë e cila më së tepërmi migron, kurse pjesa tjetër të moshës 18-24 janë në përfundim të shkollës së mesme apo në fillim të studimeve.

Tabela 3. Paraqitja e të anketuarve në lidhje me arsimimin e tyre:

Arsimimi	Fillor	I mesëm	Fakultet	Magjistër /doktor shkence
Numri i të anketuarve	176	391	137	/
Përqindje	25%	55.54%	19.46%	0%

Në tabelën 3, mund të shohim se numri më i madh është me arsimim të mesëm, pra 391 apo 55.54%, kurse me arsimim fillor është 176 apo 25%, dhe me studime deridiplomike 137 apo 19.46%, kurse me magjistraturë apo doktoratë nuk kemi hasur gjatë anketimit.

Në këtë anketë të realizuar enkas për qëllimet e këtij hulumtimi të studimit të magjistraturës, ne kemi matur përvojën multikulturore të të anketuarve në 15 qytete të ndryshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV), ku kemi marrë përgjigje mjaft interesante që do të shtjellohen në tabelat në vijim.

Tabela 4. Mendimi për multikulturalizmin:

Çfarë mendimi keni për multikulturalizmin?	Nr. (%)
Pozitiv	521 (74%)
Negative	112 (16%)
Nuk e di	71 (10%)
Total	704 (100%)

Sipas rezultateve të kësaj ankete, rreth 74% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve kanë mendim pozitiv rreth multikulturalizmit, ndërsa 16% e të anketuarve kanë mendim negativ, dhe pjesa e mbetur prej 10% përgjigjet nuk e di. Pra, me këtë përgjigje mund të konkludojmë se multikulturalizmi ka një pranim pozitiv në mesin e popullsisë së vendit tonë, pavarësisht përkatësisë etnike.

Tabela 5. Funksionimi i multikulturalizmit në RMV:

A mendoni se funksionon multikulturalizmi në RMV?	Nr. (%)
Po	151 (21%)
Jo	497 (71%)
Nuk e di	56 (8%)

Por në pyetjen rreth funksionalizimit të multikulturalizmit, shumica e të anketuarave, pra 71% kanë mendim se nuk funksionon, kurse vetëm 21% kanë mendim pozitiv, gjë që paraqet shqetësim serioz për këtë mosbesim të thellë në mesin e qytetarëve.

Tabela 6. A është në të mirën e shoqërisë multikulturalizmi?

A është në të mirën e shoqërisë multikulturalizmi?	Nr. (%)
Po	521 (74%)
Jo	112 (16%)
Nuk e di	71 (10%)

Në tabelën 6, shohim numrat identik të anketuarve me tabelën nr.4. Pra, të gjithë ata të cilët u përgjigjën se kanë mendim pozitiv (521), të njëjtit përgjigjen se multikulturalizmi është në dobi të shoqërisë, kurse ata të cilët kishin mendim negativ (112), u përgjigjën se multikulturalizmi nuk është në dobi të shoqërisë, dhe 71 u përgjigjën se nuk e di.

Tabela 7. Multikulturalizmi dhe “rreziku” për kulturat tjera:

A mendoni se rrezikohet kultura e një etnie tjetër me multikulturalizmin?	Nr. (%)
Po	112 (16%)
Jo	521 (74%)
Nuk e di	71 (10%)
Totali	704 (100%)

Edhe në këtë tabelë shohim se numri më i madh i të anketuarve 521 (74%), mendojnë se funksionimi i multikulturalizmit nuk i rrezikon kulturat e etnive të tjera, kurse 112 prej tyre kanë mendim se me funksionimin e multikulturalizmit rrezikohen etnitë tjera. Madje, sipas mendimit të tyre në veçanti rrezikohen etnitë apo kulturat autoktone të vendit, derisa 71 prej tyre u përgjigjën se nuk e dinë.

Tabela 8. Kontakti/miqësia me njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike:

A keni ndonjë shok/shoqe me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike në komunën tuaj?	Nr. (%)
Po	497 (70.59%)
Jo	151 (21.44%)
Nuk e di	56 (7.95%)
Totali	704 (100%)

Në këtë tabelë kemi një shfaqje të shpeshtësisë së kontakteve dhe miqësive me njerëz me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike nëpër komunat tona, ku 497 e të anketuarve përgjigjen me po (mbi 70%), kurse 151 të anketuarve (mbi 20%) përgjigjen me jo. Në bisedë të lire me të anketuarit se si nuk keni shok nga etnitetet tjera, ata përgjigjen se njohim njerëz të tjerë, por vetëm kur kemi ndonjë kontakt në administratë, në treg, nëpër shitore etj., por nuk i kemi shokë! Këtu është interesant edhe fakti se gjithë të anketuarit shqiptarë janë shprehur se kanë miqësi me njerëz me prejardhje tjera kulturore/etnike, por një gjë të tillë nuk e kanë shprehur të anketuarit e etnitetit maqedonas, gjë që paraqet një fakt shqetësues për funksionimit e vlerave multikulturaliste në shoqërinë tonë.

Tabela 9. Dëshira për miqësi me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike:

A dëshironi të keni ndonjë shok/shoqe me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike?	Nr. (%)
Po	497 (70.59%)
Jo	151 (21.44%)
Nuk e di	56 (7.95%)
Totali	704 (100%)

Edhe në këtë pyetje na shfaqet e njëjta situatë si në tabelën e mëparshme (shih tabelën 8). Pra, edhe këtu në pyetjen se pse nuk dëshironi të keni një shok/mik me prejardhje tjetër

kulturore/etnike, nuk japin përgjigje konkrete, por shihej qartë se nuk donin të bisedonin më shumë rreth kësaj çështjeje. Brengosë fakti që numri më i madh i tyre ishin maturantë të këtij viti. Kjo dukuri më tepër paraqitej në pjesën lindore të RMV (më mire do të shihni në tabelën ku përgjigjet janë sipas përkatësisë etnike).

Sipas tabelës 9, është evident fakti se pothuajse 71% e njerëzve të anketuar janë të gatshëm dhe dëshirojnë të krijojnë miqësi me një person me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike, dhe vetëm 21% i tyre nuk dëshirojnë të kenë shok/mik me prejardhje të ndryshme kulturore, ndërsa 8% i tyre përgjigjen me “nuk e di”.

Tabela 10. Takimet dhe shoqërimi me “të tjerët”:

<i>Sa shpesh shihen/takohen me shokun tuaj me prejardhje tjetër etnike?</i>	<i>Nr. (%)</i>
Një herë në javë	153 (22%)
Një herë në muaj	165 (24%)
Më rrallë	179 (25%)
Nuk takohemi	207 (29%)
Totali	704 (100%)

Në këtë tabelë shohim se sa shpesh të anketuarit takohen apo shoqërohen me shok/miq me prejardhje të ndryshme kulturore/etnike, brenda javës apo muajit. Këtu shohim se takimet apo shoqërimet një herë në javë janë evidente te vetëm 22% e tyre, një herë në muaj 24%, dhe më rrallë 25%. Nëse marrim grupin i cili takohet një herë në muaj dhe grupin më rrallë, shohim se ky numër arrin në 344 apo 49% e të anketuarve. Edhe më brengosës është numri 207 që paraqet 29% të të anketuarve që thonë se nuk takohen fare. Shihet qartë se këtu është fjala për ata të cilët thanë se nuk kanë miqësi me njerëz me prejardhje të tjera kulturore/etnike, gjë që nënkupton jetesë të izoluar vetëm brenda një komuniteti të caktuar.

Tabela 11. Vlerësimi i marrëdhënieve ndëretnike në komuna:

<i>Si i vlerësoni marrëdhëniet ndëretnike në komunën tuaj?</i>	<i>Nr. (%)</i>
--	----------------

Pozitive	415 (59%)
Negative	237 (34%)
Nuk e di	52 (7%)
Totali	704 (100%)

Këtu mund të shohim se prej 704 të anketuarve, 415 apo 59% i kanë vlerësuar pozitivisht marrëdhëniet ndëretnike në komunën e tyre, kurse 237 apo 34% vlerësojnë negativisht. Në këtë mes ata më shumë mendojnë për problemet e diskriminimit, racizmit, shtypjes dhe të ngjashme, kurse 52 apo 7% e të anketuarve nuk kanë ndonjë mendim dhe deklarohen se nuk e dinë.

Tabela 12. Martesa me një person me prejardhje tjetër kulturore/etnike:

A do të martoheshit me një person i cili është me prejardhje tjetër kulturore/etnike?	Nr. (%)
Po	359 (51%)
Jo	279 (40%)
Ndoshta	66 (9%)
Totali	704 (100%)

Në këtë tabelë shohim se 359 të anketuar apo gjithsej 51% prej tyre janë pro martesave me një person me prejardhje tjetër kulturore/etnike, kurse 279 apo 40% e të anketuarve përgjigjen negativisht. Vetëm 66 të anketuar apo 9% nuk kanë përgjigje definitive. Në pyetjen tonë se ku do të ishin martuar me një tjetër, shumica u përgjigjën se do të ishin martuar me të huaj/huaja diku në shtetet perëndimore, por jo në Maqedoninë e Veriut, çka gjithashtu paraqet një indikator shumë interesant që flet për funksionimin e multikulturalizmit në vend. Pra, sërish kemi situatë kur komunitetet brenda shtetit tonë s'kanë gatishmëri për krijimin e familjeve të përziera etno-kulturore-fetare, por kjo mund të bëhet në shtetet e jashtme për shkaqe dhe mundësi ekonomike, sociale, materiale më të favorshme.

Tabela 13. Interesimi për të mësuar për “tjetrin”:

A jeni të interesuar për të mësuar për komunitetet tjera dhe kulturat e tyre?	Nr. (%)
Po	497 (71%)
Jo	151 (21%)
Nuk e di	56 (8%)
Totali	704 (100%)

Edhe në pyetjen tonë rreth interesimit të tyre për të mësuar për vlerat kulturore të tjerëve, shumica nga totali janë shprehur pozitivisht (71%), dhe pak prej tyre kanë dhënë përgjigje negative (21%). Mirëpo, kur e analizojmë sipas përkatësisë së tyre etnike, na del pothuajse gjithë të anketuarit shqiptarët janë të interesuar që të mësojnë për komunitetet tjera dhe kulturat e tyre, kurse vetëm 40 % e maqedonasve kanë dhënë përgjigje pozitive në këtë pyetje, që është një indikator shqetësues.

Tabela 14. Organizimi i ngjarjeve multikulturore në komuna:

Në komunën tuaj a është organizuar ndonjë ngjarje multikulturore?	Nr. (%)
Po	112 (16%)
Jo	521 (74%)
Nuk e di	71 (10%)
Totali	704 (100%)

Në këtë tabelë shohim se nga 704 të anketuarve, 521 apo 74% përgjigjen negativisht rreth organizimit të ndonjë ngjarje multikulturore në komunën e tyre, 112 apo 16% përgjigjen pozitivisht, por vlen të cekët se në këtë numër shumica e tyre si ngjarje multikulturore përmendin ditën e komunës së tyre kur mbahet ndonjë koncert me këngëtar të ndryshëm.

Problemet e multikulturalizmit parë nga prizmi i ekspertëve

Për të parë problemet lidhur me multikulturalizmin në vendin tonë, kemi realizuar intervista me njohësit e kësaj fushe, ku njëri prej tyre është edhe prof. dr. Petar Atanasov.

Ai është i mendimit se ne në vetvete i përkasim një rajoni dhe një mjedisi që ka qenë prej kohësh një udhëkryq i besimeve dhe kulturave të ndryshme. Në periudha të caktuara, qytetërime të ndryshme imponuan vlera të ndryshme kulturore. Ballkani është i njohur për diversitetin e tij etnik dhe kulturat e ndryshme, të cilat, nëse shihen përmes marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, përfaqësojnë pasuri dhe vlerë kulturore. Ndonjëherë identitetet kulturore pasqyroheshin përmes feve apo besimeve, herë përmes gjuhëve, herë përmes dallimeve shoqërore. Por këto dallime kulturore në sisteme të caktuara politike shkaktuan probleme, ose ndikuan në marrëdhëniet midis atij që kishte pushtetin dhe popullit dhe grupeve të tyre kulturore.

Në lidhje me atë se sa investon vendi ynë në promovimin dhe respektimin e multikulturalizmit, dr. Atanasov, vlerëson se: “Vendi ynë përpiqet të menaxhojë dallimet kulturore dhe t'i ushqejë ato, por nuk investon sa duhet për promovimin e tyre. Aq më tepër që modelet politike të shtetit i kushtojnë më shumë rëndësi grupit kulturor të shumicës. Kështu është kudo në Ballkan. Shtetet e vogla ballkanike sillen si shtetet e mëdha kombëtare evropiane dhe kjo shkakton probleme në marrëdhëniet mes grupeve më të vogla dhe shumicës. Në vitin 2019, vendi ynë miratoi një Strategji Kombëtare për Ndërkulturalizmin dhe Një Shoqëri për të Gjithë, por e vështirë për t'u zbatuar”.

Ndërsa, ne u interesuam të dimë edhe mendimin e tij rreth rolit të shoqërisë civile dhe medias në ndërtimin e shoqërive multikulturore në vendin tonë. Sipas Atanasovit, shoqëria civile ka ndikimin e saj dhe përpiqet të sillet si një shoqëri e vërtetë civile, ku dallimet etnike apo kulturore nuk do të kenë ndikim dominues në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Por marrëdhëniet më së shumti varen nga sistemi politik dhe qëndrimi i institucioneve shtetërore ndaj këtyre çështjeve. Kur qeveria ka një ndjenjë të dallimeve etnike, atëherë marrëdhëniet janë pozitive. Por kur forcat politike punojnë në mënyrë etnocentrike, atëherë shoqëria civile

përballet me tensione dhe zhgënjime. Nacionalizmi është një ideologji e fortë dhe shpesh dominon në marrëdhëniet shoqërore.

Ndërsa, rreth çështjes se ku mund të gjejë më shumë ndikim multikulturalizmi në zgjidhjen e problemeve sociale, për të dalë në pah edhe roli i tij lehtësues, prof. Petar Atanasov mendon se institucionet shtetërore duhet të kujdesen që disa komunitete apo familje nga grupe të ndryshme kulturore të mos diskriminohen dhe të mos mbeten në margjinat e shoqërisë. Problemet sociale janë veçanërisht të mëdha tek të varfërit, në zonat rurale, tek gratë e papuna dhe tek të rinjtë. Por këto grupe shoqërore ekzistojnë në të gjitha bashkësitë e ndryshme kulturore, si në shumicë ashtu edhe në pakicë. Një shtet i zgjuar duhet të punojë në një program të mirë social dhe të mos lejojë varfërinë strukturore dhe diskriminimin.

Multikulturalizmi, pas promovimit të tij teorik në nivel botëror në vitet '90 të shekullit të kaluar, solli shumë keqkuptime dhe nuk është një ide shumë e njohur në Evropë. Shoqëritë e emigrantëve si Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Australia e kanë më të lehtë të merren me këto çështje. Ka shumë tensione në Ballkan për këto çështje. Çdo shtet përpiqet të jetë shtet kombëtar i një populli apo bashkësie kulturore. Nëse duam që kulturat të mbeten thesar, atëherë shtetet e rajonit duhet të zhvillojnë më shumë praktikatat e tyre demokratike, por edhe të punojnë për përparim ekonomik dhe prosperitet të qytetarëve. Shoqëritë multikulturore si Maqedonia e Veriut dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë sfida të mëdha në menaxhimin e këtyre çështjeve.

Dhe, në pyetjen tonë se cilat janë sfidat më të mëdha, por edhe perspektivat e multikulturalizmit në vend dhe rajon, dr. Atanasov pati këtë mendim: “Sfidat janë të mëdha, sepse në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar në Ballkan kanë ndodhur disa konflikte në baza etnike apo kombëtare. Multikulturalizmi është një materie e brishtë dhe nuk mund të korrigjojë në vetvete padrejtësitë në shtet apo shoqëri. Është më mirë që shtetet të demokratizohen më shumë dhe në të njëjtën kohë t'u mundësojnë të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve kulturore të kenë një standard të mirë dhe kushte më të mira jetese. Të drejtat e njeriut përfshijnë të drejtat dhe liritë civile, por edhe të drejtat kulturore. Por ndërsa të drejtat e njeriut janë të drejta universale, të drejtat kulturore janë kolektive dhe nuk rregullohen në mënyren e njëjtë në gjitha vendet. Në shumicën e vendeve, bashkësitë kulturore që janë më të vogla se shumica

trajtohen si pakicë dhe në këtë mënyrë rregullohen me ligj. Në vendin tonë këto të drejta janë të rregulluara mirë me Kushtetutë, veçanërisht pas miratimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit”.

-Hipoteza nga anketat dhe intervista:

Me këto rezultate është konfirmuar hipoteza se të anketuarit apo një pjesë e madhe e të rinjve (shkollarë të mesëm), kanë shumë pak përvoja multikulturore. Ata shumë e pak e njohin njëri – tjetrin dhe secila nga grupet kulturore/etnike është e mbyllur në vetvete dhe shumë pak komunikojnë me njëra – tjetrën. Është mjaft shqetësues fakti se shumica e të anketuarve që kanë mbaruar shkollën e mesme nuk kanë dëgjuar asnjëherë përmbajtje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkulturore dhe ndërkulturalizmin. Dhe, edhe më shqetësues janë indikatorët etnikë kur kemi të bëjmë me përvojat multikulturore. Një numër i madh i të rinjve të nacionalitetit maqedonas nuk kanë përvoja multikulturore dhe as që kanë interes të njohin kulturat e tjera, derisa opinionet e të rinjve shqiptarë janë më pozitiviste dhe më optimiste në drejtim të vlerave multikulturore. Me këtë vërtetohet hipoteza e qasjes më liberale të bashkësisë etnike shqiptare ndaj etnive dhe kulturave të tjera.

Funksionimi i multikulturalizmit si shembull praktik në rrethet shoqërore të shqiptarëve në RMV, mund të merret edhe inkuadrimi i një numri të madh të shqiptarëve në partitë politike maqedonase në dy-tre ciklet e fundit zgjedhore, që të cilët madje janë përfaqësues edhe nëpër pozita të larta shtetërore (deputetë, ministra, prefektë komunash, etj.). Mirëpo, deri më tani nuk kemi asnjë shembull të inkuadrimin të tillë të maqedonasve nëpër partitë politike shqiptare. Këto anketa tregojnë se sa janë të thella ndasitë etno-kulturore në Maqedoninë e Veriut dhe flasin mjaft për vështirësitë në qasje ndaj vlerave multikulturore të grupeve të caktuara etnike kundrejt grupeve tjera etnike. Pra, multikulturalizmi në vendin tonë ka nevojë edhe shumë më tepër të zbatohet në të gjitha sferat shoqërore, dhe nëpërmjet edukimit dhe arsimimit të mirëfilltë multikulturor, të tejkalohen këto barrierat dhe paragjykimet që ende ekzistojnë brenda komuniteteve të ndryshme etnike.

Edhe mendimi i ekspertit prof. dr. Petar Atanasov, ishte në drejtim të asaj që të ketë më tepër impenjim të të gjithë faktorëve për të pasur sukses shtetet multikulturore, siç është edhe

Maqedonia e Veriut. Ai tha se nëse duam që kulturat të mbeten thesar, atëherë shtetet e rajonit duhet të zhvillojnë më shumë praktikat e tyre demokratike, por edhe të punojnë për përparim ekonomik dhe prosperitet të qytetarëve të tyre. Edhe ai e shesh si shumë të rëndësishme qasjen e strukturave shtetërore ndaj ideve multikulturaliste, meqë ato ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në opinionin e shoqërisë civile, si shumë e rëndësishme për zhvillimet demokratike.

Multikulturalizmi paraqet një model mjaft të mirë lehtësues për tejkalimin e shumë situatave konfliktuoze ndërkulturore në vendin tonë, por edhe në rajon e më gjerë, mirëpo vlerat e tilla multikulturore duhet të pranohen gradualisht nga të gjithë përbërësit kulturorë pa përjashtim, në mënyrë që ky model të jetë i suksesshëm.

2.2. Multikulturalizmi si model i ri lehtësues në rajon dhe në sistemin ndërkombëtar

Multikulturalizmi është dëshmuar si një sistem dhe model mjaft i avancuar lehtësues në krijimin e shoqërive të fuqishme kohezive në botë dhe në sistemin ndërkombëtar. Edhe në rajonin tonë poashtu është sforcuar si një model që hapë perspektiva të reja sidomos për shtetet dhe shoqëritë që kanë diversitet të theksuar dhe ndasi në linjat etnike e fetare. Pikërisht paaftësia për të kuptuar drejtë konceptin e multikulturalizmit, në të kaluarën ka sjellë probleme të mëdha dhe fërkime të vazhdueshme që kanë shkuar deri në konflikte të ashpra luftarake në mes popujve të ndryshëm në mbarën hapësirën ballkanike, të njohur tani më tepër si Evropë Juglindore. Prandaj, është shumë i rëndësishëm ballafaqimi me të kaluarën dhe kapërcimi i ndasive dhe mosmarrëveshjeve ndërnacionale e ndërjetare, në mënyrë që pasardhësve t'ua garantojmë një ardhmëri më të sigurtë, në paqe dhe stabilitet afatgjatë.

Ballafaqimi me të kaluarën është një proces i pranishëm gjithandej dhe i përditshëm i udhëhequr nga publiku në një shoqëri pas luftës. Përvoja e luftës, koha e tmerrit, çnjerëzimit,

lëndimit, dhimbjes dhe frikës, ndryshon gjithë klimën shoqërore, marrëdhëniet ndërnjerëzore, pikëpamjet e komuniteteve të tjera, bazat e komunikimit dhe rendit shoqëror, ajo lë shenja të thella në psikikën e njerëzve të prekur se realiteti i pasluftës është përcaktuar ndjeshëm nga përvoja e luftës (Franoviq, Vukosavljeviq, 2000:41). Siç dihet, të vërtetat, për të cilat besohet se ekzistojnë gjatë luftës, mbeten edhe më tej të ekspozuara në mospajtimet për mungesën e luftës. Lufta ndalon, vrasja pushon, por lufta në kokat e njerëzve vazhdon, bashkë me ndjenjat e dhimbjes. Kështu, interpretimi i luftës bëhet shumë i rëndësishëm brenda shoqërisë, pasi që shihet nevoja që humbjeve dhe vuajtjeve t'u jepet njëfarë kuptimi.

Ish - Federata Jugosllave që u formua me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, nën udhëheqjen e Josip Broz – Titos, përbënte një konglomerat popujsh me gjuhë e fe të ndryshme, një diversitet të madh etnik e fetar, që në fakt ishte trashëguar edhe nga Jugosllavia e vjetër. Pra, në përbërje strukturore, Jugosllavia ishte një model i shtetit multikulturor, por problemet lindën në momentin kur njëra kulturë (ajo serbe), filloi të shtrihej hegjemoninë e vetë ndaj kulturave tjera (sllovene, kroate, boshnjake, malazeze, maqedonase, shqiptare), duke prishur raportet thelbësore të komunikimit ndërkulturor, veçanërisht në periudhën pas vdekjes së Titos.

Politikologu David Brown, lidhur me fenomenin e nacionalizmit në territoret e ish-Jugosllavisë shkruan se: „Dilema thelbësore për multikulturalizmin jugosllav ishte, megjithatë, tensioni midis nacionalizmit qytetar dhe nacionalizmit etnokulturor brenda secilës prej republikave dhe krahinave përbërëse” (Brown, 2000:165). Pra, mosmenaxhimi i duhur me kohë i dallimeve nacionale dhe kulturore, solli deri te ashpërsimi i retorikave nacionaliste, sidomos asaj serbe, që shkatërroi gjithçka që ishte ndërtuar dekadat e mëhershme.

Në fakt, shkatërrimi përfundimtar i Jugosllavisë komuniste në fillim të viteve '90-ta të shekullit XX, i gjeti të papërgatitura shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të botës demokratike. Procesi nisi me mënjanimin në formë grushti të shtetit të udhëheqjeve komuniste, republikane e krahinore, në Mal të Zi, Vojvodinë dhe Kosovë duke u zëvendësuar me njerëz të afërt të Milosheviqit.

„ Pas përshkallëzimit të konflikteve të armatosura më 1998, vetëm në pranverë 1999 dhe sërish me intervenimin e NATO-s, qe e mundshme të ndërpritej spastrimi etnik dhe vrasjet masive të popullatës shqipfolëse” (Hajrullahu, 2015:9). Po ashtu, konflikte të dhunshme luftarake mes kryengritësve shqiptarë dhe shteteve përkatëse pati edhe në jugun e Serbisë (Lugina e Preshevës) dhe në Maqedoni, të cilat u fashitën përmes një procesi të vështirë negociimesh, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë u përfshinë përfaqësues të lartë të bashkësisë ndërkombëtare (SHBA, NATO dhe BE). Si rezultat i atyre ndërhyrjeve, avancimit të dukshëm e të drejtave kombëtare, gjuhësore dhe fetare, u arrit paqe deri diku stabile në rajon, me predispozita konkrete për ruajtjen e shumëllojshmërisë etniko - kulturor, si në Bosnjë, Kosovë dhe Maqedoni.

Sipas indeksit Global të Paqes, „Evropa është zakonisht rajoni më i mirë i ranguar në botë që nga futja e indeksit në vitin 2008. Në raportin e vitit 2021, tetë nga dhjetë vendet më të vlerësuara janë në Evropë” (Simonida Kacarska, Indeksi Global i Paqes – disa mësimet për Ballkanin Perëndimor, 21.09.2021: <https://epi.org.mk/post/17855?lang=sq>. Shikuar më 29.07.2022). Kjo ka një domethënie jashtëzakonisht të madhe, për faktin që në nivel botëror, Evropa ku bëjmë pjesë edhe ne, përbën një tregues pozitiv në aspekt të paqes dhe sigurisë.

Mirëpo, vendet e Ballkanit Perëndimor janë tradicionalisht në fund të indeksit në kontekstin evropian, duke treguar nevojën për të punuar në përmirësimin e të gjitha dimensioneve. Në dy vitet e fundit, Maqedonia e Veriut pa dyshim ka pasur hapin më të madh në rajon për shkak të përparimit në fushën e konflikteve të vazhdueshme, përmes zgjidhjes së mosmarrëveshjes së emrit me Greqinë fqinje. „ Përkundër sfidave të shumta që ekzistojnë, ende vlerësohet që kjo çështje në vend nuk ka më aq potencial për të krijuar konflikte. Me këtë ngjitje, Maqedonia e Veriut është në vendin e 40 -të në indeks, e ndjekur nga Serbia (44), Shqipëria (48) dhe Mali i Zi (51) në 10-shen e radhës” (Simonida Kacarska, Indeksi Global i Paqes – disa mësimet për Ballkanin Perëndimor, 21.09.2021: <https://epi.org.mk/post/17855?lang=sq>.__Shikuar më 29.07.2022)

Këto statistika tregojnë për qëndrueshmëri solide dhe paqe në Ballkanin perëndimor, i cili si një rajon multikulturor, poashtu njihet si më problematiku i Evropës Juglindore, për çka flasin edhe vonesat e shumta në rrugën e integritetit të tyre të plotë në familje e madhe të popujve të

qytetëruar të Bashkimit Evropian. E, në fakt, tani e tri dekada me radhë, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor, angazhohen të zbatojnë politikat e multikulturalizmit, që mund të sjellin më shumë paqe dhe stabilitet shoqëror në këtë rrugë zhvillimore. Këto politika dhe projekte sigurojnë një orientim më të qartë drejt progresit të tyre europerëndimor, të prirë nga SHBA dhe BE.

Bota në tërësi është një shoqëri multikulturore dhe ajo funksionon normalisht vetëm në rastet kur respektohen të drejtat dhe liritë e çdo individi në atë shoqëri. Kanadaja, SHBA-ja, Australia është shembulli më i mirë për funksionimin e shoqërive multikulturore, rrjedhimisht politikat multikulturaliste kanë luajtur rol të veçantë në përparimin e atyre shoqërive, që sot janë vende udhëheqëse në botë për nga zhvillimi ekonomik, kulturor, arsimor, demokratik, etj. Pra, në sistemin ndërkombëtar, multikulturalizmi ka luajtur rol shumë të madh lehtësues në zgjidhjen e problemeve brenda komuniteteve divergjente.

Në sistemin ndërkombëtar, multikulturalizmi njihet si sistem lehtësues, duke i përdorur avantazhet e tij, si janë: prania e mirëkuptimit dhe respektit për dallimet kulturore ndaj njërit-tjetrit; rritja e kreativitetit, duke parë tradita dhe modele të ndryshme dhe punës së njerëzve nga vende të ndryshme të botës; siguri i një fuqie punëtore shumë efikase që vjen zakonisht përmes emigrimit të njerëzve me standard më të ulët jetësor; mundësia që secili komunitet të flet gjuhën e vetë amtare, të respektojë normat e veta nga religjioni apo tradita e vendit të origjinës; mundësia që të mësojnë më shumë gjuhë të huaja, të cilat paraqesin pasuri shtesë për secilin individ të shëndosh në një shoqëri, etj. (Pse të punoni në një mjedis multikulturor? <https://lwworc.org/sq/why-work-in-a-multicultural-environment>. Shikuar më 30.07.2022)

Por, në anën tjetër, multikulturalizmi ka edhe disavantazhet ose anët e veta negative, të cilat ndikojnë që të rritet skepticizmi i njerëzve në këtë sistem. Në mesin e këtyre disavantazheve po përmendim: tensionet e shpeshta mes njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore, etnike, religjioze e racore; vështirësia që kanë disa individë të integrohen brenda një shoqërie multikulturore; barrierat gjuhësore paraqiten si një problem mjaft i madh që ndikon në pamundësinë e komunikimit normal; frika e shumë njerëzve, rëndomë më konservatorë, se me multikulturalizmin do të humbasin identitetin e tyre kulturor, kombëtar, gjuhësor, racor etj.

„Dhe, një nga mangësitë më të mëdha që mund të llogaritet edhe si devijim i frymës së vërtetë të multikulturalizmit, është se ai mund të promovojë jetë të ndara dhe paralele të njerëzve apo grupeve kulturore, të cilët mbyllen në vetvete dhe krijojnë enklava të caktuara shoqërore, gjë që mund të paraqesë një sfidë të vërtetë për barazinë e tyre efektive në shoqëritë demokratike dhe liberale”. (<https://lwworc.org/sq/why-work-in-a-multicultural-environment>. Shikuar më 30.07.2022)

Shikuar në këtë aspekt, kohën e fundit multikulturalizmi si koncept ka pasur goditje të mëdha edhe nga majat e pushtetit të vendeve të fuqishme evropiane, të cilat me dekada të tëra e kanë kultivuar këtë koncept, siç janë Gjermania, Franca, Britania e Madhe, etj.

Sot, një numër në rritje i njerëzve e konsiderojnë multikulturalizmin si shkaktar të problemeve sociale në Evropë. Ky perceptim ka bërë që shumë politikanë, përfshirë ish-kryeministrin britanik David Cameron dhe ish-kancelaren gjermane Angela Merkel, të denoncojnë publikisht multikulturalizmin dhe të flasin kundër rreziqeve të tij. Ish-kancelarja gjermane Angela Merkel, në tetor të vitit 2010 bëri një deklaratë të fortë, duke thënë se përpjekjet për të ndërtuar një shoqëri multietnike në Gjermani kishin dështuar. Sipas saj, koncepti i ashtuquajtur ‘multikulti’, sipas të cilit njerëzit ‘do të jetonin krah për krah’ të lumtur, nuk kishte funksionuar, dhe se imigrantët janë ata që duhet të bëjnë më shumë për t'u integruar në vend, duke filluar nga mësimi i gjermanishtes. "Ideja e (ndërtimit të një shoqërie) multietnike dhe për të jetuar krah për krah... ka dështuar, ka dështuar krejtësisht" (A ka dështuar multikulturalizmi?, BBS Shqip, 29.10.2010: https://www.bbc.co.uk/albanian/forum/2010/10/101018_multikulti.shtml. Shikuar më 05.08.2022) tha Merkel në Potsdam.

Pra, multikulturalizmi është më tepër sesa thjesht respektimi i kulturave të njëri-tjetrit. Ai ka të bëjë para së gjithash me zhvillimin e modeleve të reja të demokracisë qytetare, bazuar në të drejtat e njeriut, gjithnjë duke respektuar qytetarin pavarësisht nga origjina e tij apo shtrati kulturor që i takon.

2.3. Edukimi multikulturor

Krijimi i një shoqërie me individë të shëndoshë dhe të emancipuar kulturalisht, fillon që me lojërat e çerdheve, vazhdon nëpër bankat e shkollës fillore e të mesme, në amfiteatrot e fakulteteve, në zyrat dhe ambientet e punës, në familje dhe mbaron me mbarimin e ciklit jetësor. Pra, e një rëndësie të jashtëzakonshme për arritjen e efekteve të duhura në edukimin dhe arsimimin multikulturor, është organizimi i mirë dhe cilësor i sistemit edukativ dhe arsimor brenda shoqërive të caktuara me predispozita multikulturore.

Shi për këtë qëllim, në shumicën e shteteve të Evropës, përfshirë edhe vendet tona ballkanike aspirantë për aderim në Bashkimin Evropian, qysh moti kanë filluar të hyjnë nëpër plan-programe mësimore lëndë dhe koncepte nga edukimi dhe arsimimi multikulturor. Nëpër kurikulat e fakulteteve të shkencave sociale, jepen lëndë të veçanta për multikulturalizmin. Për më tepër, janë kryer hulumtime të shumta dhe janë realizuar projekte të shumta në drejtim të promovimit të konceptit të multikulturalizmit brenda sistemeve tona edukative dhe arsimore.

Edukimi multikulturor është “një përpjekje totale për reformën e shkollës, e krijuar për të rritur barazinë arsimore për një sërë grupesh kulturore, etnike dhe ekonomike”. Qëllimet e edukimit multikulturor janë shumëdimensionale. „ Dimensionet përfshijnë integrimin e përmbajtjeve në kurrikulën gjithëpërfshirëse e shkollimit fillor dhe të mesëm, proceset e njohurive të fituara multikulturore, reduktimin e paragjykimeve dhe diskriminimit, një pedagogji të barazisë dhe një fuqizim të kulturës shkollore dhe sociale për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë” (Vavrus, 2002:22). Në fakt, edukimi multikulturor mund t'i ndihmojë mësuesit të fitojnë më shumë njohuri, aftësi dhe dispozita që u shërbejnë të gjithë fëmijëve dhe të rinjve, veçanërisht nxënësve, interesave të të cilëve janë marginalizuar historikisht nga institucionet dhe njerëzit nga pozitat e privileguara. Për të arritur këtë qëllim, nevojiten mësues të përgjegjshëm nga ana kulturore dhe mësues adekuat zhvillim profesional në institucionet e përkushtuara për edukimin multikulturor.

Qëllimi themelor i edukimit multikulturor duhet të jetë promovimi dhe forcimi i mirëkuptimit të ndërsjellë mes bashkësive të ndryshme dhe grupeve të ndryshme kulturore shumicë dhe pakicë. Edukimi multikulturor duhet të zbatohet në grupin i cili është me përbërje të ndryshme etnike, religjioze dhe kulturore. Nuk është e mundur të ndërtohet shoqëri multikulturore, e të bëhet fjalë vetëm për njërin nga palët e përfshira, vetëm për grupet e pakicave, respektivisht për grupet e shumicës. Nevojat e shumicës dhe pakicës janë të ndryshme, por të lidhura ndërmjet veti.

„Qëllimi i përcaktuar do të thotë se dallimi mbështetet në barazi dhe nuk duhet të shndërrohet në arsyetim për marginalizim; të bëhet përpjekje për pranim të identiteteve të ndryshme kulturore, grupeve etnike dhe përpjekje për respektim të pakicës; transformim paqësor dhe jo i dhunshëm, dhe zgjidhje e interesave të konfliktit” (Cívica & Antico, 2010:11).

Në kohën e sotshme, përfshirja e multikulturës në procesin arsimor është tendencë globale. „Pikërisht arsimi multikulturor është i domosdoshëm për shoqërinë tonë, për shkak se i përfshinë aspektet e tolerancës dhe besimit ndëretnik, për të cilat mund të themi gati se mungojnë në arsimin formal” (Zenuni-Idrizi, 2017:325). Prandaj, detyrë dhe qëllim primar në shoqëritë multi-etnike është që me përmbajtje programore dhe projekte të ndryshme multikulturore të bëhet integrimi, e me këtë edhe ngritja e nivelit arsimor dhe realizimi i vizionit për zhvillim multikulturor. Për këtë është e nevojshme që të ndërtohen politika arsimore me strategji adekuate, që do të jenë në funksion të zbatimit të përmbajtjeve mësimore me karakter multikulturor.

Realiteti multikulturor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është rregulluar me Kushtetutë dhe me më shumë akte ligjore dhe nënligjore. Kushtetuta e vendit çdo individ i garanton të drejtën e arsimit, me kushte të barabarta, gjë që e nënkupton esencën e konceptit të arsimit multikulturor dhe më vonë edhe konceptit të ri për arsimim interkulturor.

„Në shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë, në mjediset multi-etnike, mësimi i rregullt zhvillohet në gjuhën amtare të nxënësve (maqedonase, shqipe, turke, serbe), ndërsa pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike (romë, vllehë, boshnjakë) kanë mundësi të zgjedhin që në mënyrë fakultative ta mësojnë gjuhën e tyre amtare”. (Qendra Maqedonase për Edukim

Qytetar, Shkup, 2011: 16). Aktivitetet jashtëmësimore të nxënësve realizohen ndaras, e në veçanti në shkollat ku mësimi organizohet në ndërrime “të pastra” etnike.

Ndikim të madh mbi krijimin e politikës dhe praktikës edukative-arsimore në Republikën e Maqedonisë për zhvillimin e arsimit ka pasur Programi nacional 2005-2015. Ai në mënyrë të qartë e ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndëretnik dhe ndërkulturor në procesin edukativ-arsimor duke filluar që nga mosha parashkollore, në drejtim të fuqizimit të kohezionit, të tolerancës, respektit dhe besimit të ndërsjellë.

Duke iu referuar broshurës së përgatitur prej Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, me temë “Koncept i arsimit interkulturor” (Shkup, 2015), veprimtaria edukative-arsimore në institucionet parashkollore në vend, nga viti 2013 mbështetet mbi Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, dhe nga viti 2014 në Programin për mësim-nxënie të hershme dhe zhvillim. Programi mbështetet mbi parime të cilat mundësojnë krijimin e përmbajtjeve edukative-arsimore të këtij karakteri, si në vijim:

- parimi i mundësive të barabarta dhe respektimi i dallimeve midis fëmijëve dhe parimi i multikulturalizmit;
- parimi i demokracisë;
- parimi i dominimit të lojës dhe parimi i lidhjes me realitetin jetësor;
- parimi i mësim-nxënies aktive dhe stimulimit të mënyrave të ndryshme të të shprehurit;
- parimi i harmonizimit me karakteristikat e të rriturve dhe parimi i individualizmit;
- parimi gjithëpërfshirës dhe i integritetit;
- parimi i transparencës së procesit edukativ-arsimor;
- parimi i mbikëqyrjes dhe stimulimit të zhvillimit të fëmijëve;
- parimi i qasjes zhvillimore - procesuale;
- parimi i vlerësimit kritik;

-parimi i zhvillimit profesional të vazhdueshëm të edukatorit (Koncept i arsimit interkulturore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shkup, 2015: 9-10).

Pra, ekziston një gamë e gjerë e parimeve të vendosura në procesin edukativo-arsimor që duhet përshtatur modeleve multikulturore, por megjithatë është një pikëpyetje e madhe zbatimi i tyre praktik nga ana e edukatorëve dhe mësimdhënësve, gjë që reflekton në gjendjen aktuale me vlerat multikulturore të shoqërisë sonë.

Tekstet shkollore kanë rol të veçantë për ndërtimin e perceptimit tek nxënësit ndaj diversitetit të njerëzve në botë dhe mjedisit në të cilin jetojnë. Hulumtimet tregojnë se mënyra me të cilën janë përfaqësuar të tjerët në një tekst shkollores ndikon tek nxënësit e tjerë në formimin e qëndrimeve lidhur me ato grupe. Nëse në tekstet shkollore janë përfshirë më shumë shembuj pozitiv, të cilët kanë përcaktim të saktë për ndërtimin e shoqërisë multikulturore, të cilat më shumë i spikasin parimet themelore të interkulturalizmit, atëherë ekzistojnë parakushte reale nxënësit të formojnë qëndrime, opinione dhe sjellje pozitive në raport me të tjerët (Hulumtimi i përmbajtjes së librave shkollores në arsimin fillor, Shkup, 2016:6).

Siç thamë, janë bërë edhe projekte dhe hulumtime shkencore lidhur me përmbajtjen e frymës së multikulturalizmit nëpër tekstet mësimore të shkollave tona në Maqedoninë e Veriut. Njëri nga ta është edhe hulumtimi i kryer nga një grup specialistësh të organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, prej ku kanë dalë konkluzione shumë interesante, por fatkeqësisht jo shumë shpresëdhënëse.

Kështu, për shembull, nga analiza e realizuar ndaj librave shkollores në gjuhën maqedonase, të arsimit fillor nëntëvjeçar nga klasa e parë deri në të pestën, mund të konkludohet që përfaqësimi i elementeve multikulturore nuk është shumë i shprehur; më të përfaqësuar janë tekstet, pyetjet, detyrat dhe ilustrimet të cilat kanë të bëjnë me identitetin kulturor të popullit maqedonas, ndërsa identiteti kulturor i pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike, të cilat jetojnë në Maqedoni, është përfaqësuar me numër të vogël të teksteve dhe ilustrimeve; në tekstet shkollore është përfshirë një numër i vogël i teksteve dhe ilustrimeve të cilët e vënë në dukje interaksionin midis bashkësive të ndryshme etnike; më shumë se gjysma e autorëve të veprave letrare, të cilët janë përfaqësuar në tekstet shkollore, janë maqedonas; autorët e bashkësive të

tjera etnike janë përfaqësuar shumë pak, etj. (Hulumtimi i përmbjatjes së librave shkollor në arsimin fillor, Shkup, 2016:6). Këto elemente të mungesës së frymës së duhur në edukimin dhe arsimimin multikulturor në shoqërinë tonë, paraqesin pengesë serioze në zhvillimin e konceptit të multikulturalizmit, dhe rrjedhimisht paraqesin pengesë serioze në aspiratat tona për aderim në familjen e madhe evropiane.

2.4. Shumëgjuhësia në shoqëritë multikulturore

Një aspekt shumë të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërive multikulturore përbën shumëgjuhësia. Mënyra se si është e rregulluar çështja e përdorimit të gjuhëve në një shtet multi-etnik ose shoqëri multikulturore, është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me progresin e saj të drejtë pozitiv drejt trendëve të shoqërive bashkëkohore.

Njëra nga shenjat e shoqërisë moderne demokratike është shkalla e lartë e respektit ndaj identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të çdo qytetari në suaza të shtetit, si dhe mundësimi i një mjedisi të favorshëm për ta shprehur, ruajtur dhe zhvilluar atë identitet. „Shumëllojshmëria gjuhësore, si një nga elementet që i karakterizon shoqëritë shumëgjuhëshe, kontribuon në pasurimin e bashkësisë shoqërore” (Sela, Matovski, 2022 : 14).

Duke qenë se shumica e shteteve në rajon, Evropë dhe botë, në thelb janë shtete dhe shoqëri multikulturore, nënkupton edhe faktin se në to ka edhe laramani gjuhësor. Shumë shtete të tilla në sistemet demokratike kanë më shumë se një gjuhë zyrtare, dhe funksionimi i tyre nuk ka kurrfarë pengesash. Shumica e njerëzve këtë gjë e shohin si përparësi, meqë komuniteteve më të mëdha u mundësohet përdorimi i lirë i gjuhës së tyre amtare, që shpreh një lloj tolerance, mirëkuptimi dhe qytetarie nga ana e folësve të gjuhës së shumicës.

Siç dihet, në botë fliten rreth 6000 deri 7000 gjuhë, nga të cilat diku 225 gjuhë në kontinentin e Evropës llogariten se janë vendase. Në jetën e përditshme evropianët gjithnjë e më shumë

hasin gjuhë të huaja, prandaj „ekziston nevoja për të ngjallur një interes më të madh për gjuhët mes qytetarëve evropianë. Gjuhët janë vazhdimisht në kontakt dhe ndikojnë njëra-tjetrën në shumë mënyra. Anglishtja në të shkuarën ka huazuar fjalë dhe shprehje nga shumë gjuhë, sot gjuhët evropiane po huazojnë fjalë nga gjuha angleze” (Fakte gjuhësore: <https://edl.ecml.at>. Shikuar më 20.08.2022). Në Ballkan shumica e shteteve edhe pse janë multietnike, në përdorim të përditshëm ka mungesa të mëdha të zbatimit praktik të gjuhëve edhe të popujve që përbëjnë pjesë të konsiderueshme të shteteve respektive. Antagonizmat etnik vazhdojnë të jenë prezentë në këto treva edhe në shekullin XXI, dhe shpeshherë temat e tilla identitare, siç është gjuha dhe simbole kombëtare, bëhen shkak i përplasjeve të mëdha ndëretnike.

Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut përbëjnë më tepër se çerekun e popullsisë së përgjithshme në shtet, deri vonë nuk kishin të drejtat për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe. Pas konfliktit të vitit 2001 dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, u bënë disa ndryshime ligjore që avanconin të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe, deri në zyrtarizimin e saj, megjithatë jo të plotë, në vitin 2018.

Ligji për përdorimin e gjuhëve (LPGJ), me të cilin rregullohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe, u miratua më 14 mars të vitit 2018, por për shkak të neglizhencave institucionale, ai hyri në fuqi më 14 janar 2019, me publikimin në Gazetën zyrtare të RMV-së. Me këtë Ligj parashihet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe, apo gjuhës që e flasin së paku 20% e popullatës, në qeveri, kuvend, organet e pushtetit gjyqësor dhe administratën publike, si në të folur ashtu edhe në të shkruar, që nënkupton të gjitha tabelat dhe mbishkrimet do të jenë në dy gjuhë. Me këtë rast, po e citojmë vetëm Nenin 1 me 4 paragrafët e këtij Ligji, për të parë natyrën e tij:

(1) Në tërë territorin në Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik;

(2) Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj;

(3) Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe organizatat, komisionet,

personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj;

(4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale (Shih: Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Gazeta Zyrtare e RMV nr.7, Shkup, 14 janar 2019:14-19).

Sigurisht, përdorimi i gjuhëve është një shoqërues i domosdoshëm i funksionalitetit, nëse synojmë një vetëqeverisje lokale efikase dhe efektive. Kjo është e pamundur pa bashkëpunimin dhe mbështetjen e pushtetit qendror dhe atij lokal. Sidoqoftë, nuk duhet harruar se përdorimi i gjuhës doli në pah në vitin 2019 me krijimin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve të RMV-së. „Arritja e qëllimeve të LPGJ-së, të cilat synojnë promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e njëtrajtshëm të gjuhës, ligjvënësi ia delegoi Agjencisë, arritja e së cilës lidhet me suksesin e procesit të standardizimit dhe të përdorimit të njëtrajtshëm të gjuhës dhe të alfabetit të saj si kompetencë e entitetit institucional të sapoformuar" (Sela, Zejneli, Shasivari, Hajretin, Salii, Matovski 2021: 8-9). Ndërsa, për të siguruar zbatimin e plotë dhe të qëndrueshëm të zgjidhjes së re ligjore për gjuhët, u krijua një tjetër institucion shtesë – Inspektorati i Përdorimit të Gjuhëve, puna e të cilit, rregullohet me ligj të veçantë - Ligjin e Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve.

Megjithatë, zbatimi praktik i gjuhës shqipe në mënyrë institucionale vazhdon të ketë pengesa të çdoditshme, sidomos nëpër institucionet që nuk udhëhiqen nga kuadro shqiptare. Kjo në masë të madhe lë për të dëshiruar sa i përket gatishmërisë së palës maqedonase për ta kuptuar shumëgjuhësinë si një vlerë të shtuar për shtetin në mesin e shoqërive multikuturore. Kështu, mediat vazhdimisht raportojnë për shkelje ligjore në zbatimin e gjuhës shqipe nga institucionet komunale apo shtetërore.

Përdorimi i gjuhës shqipe në institucionet shtetërore e publike, ndonëse i përcaktuar me ligj, has në pengesa të shumta. Për shembull, në kuadër të Qytetit të Shkupit, në Qendrën Informative Kulturore, janë hequr mbishkrimet në gjuhën shqipe, të vëna paraprakisht nga drejtoresha shqiptare. Në këtë institucion nuk respektohet Ligji për përdorimin e gjuhëve, ndërsa drejtori aktual maqedonas nuk përgjigjet përse i pengon shqipja?! (Përdorimi i gjuhës shqipe, varësisht nga vullneti i drejtorëve – Ende nuk ka zbatim të ligjit, 22.04.2022, Shkup, <https://alsat.mk>. Shikuar më 25.08.2022). Pas reagimeve të shumta në opinion, ndonëse me vonesë, Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve realizoi inspektim të jashtëzakonshëm në hapësirat e QIK-ut për të konstatuar gjendjen faktike lidhur me zbatimin e gjuhës shqipe në këtë institucion.

Rastet e këtilla, sikurse ky i lartpërmenduri në një institucion publik nën kompetenca të Qytetit të Shkupit, janë të shpeshta. Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe vëzhgimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, siç janë Agjencia dhe Inspektorati, janë institucione relativisht të reja dhe ende jofunksionale me kapacitete të plota, gjë që lë hapësirë edhe për devijime të tilla ligjore.

2.5. Mediat dhe komunikimi multikulturor

Mediat kanë rol shumë të madh në ngritjen dhe zhvillimin e proceseve multikulturore në një shoqëri të caktuar. Mundësia e një komunikimi të shëndoshë mediatik dhe multikulturor, është i një rëndësie të veçantë për të krijuar rrethana lehtësuese në zhvillimet e qëndrueshme shoqërore në sistemin vendor dhe ndërkombëtar. Mediat, që nga zanafilla e tyre, përbëjnë mjetin kryesor të komunikimit në botë, dhe kështu bëhen po aq të rëndësishme edhe për zhvillimin e komunikimit multikulturor në këtë botë me një kolorit të madh gjuhësh e kulturash.

Komunikimi me mediat, e përmes tyre edhe me opinionin publik, sot kryesisht bëhet përmes mediave tradicionale, përmes internetit dhe rrjeteve sociale. Në pjesën e tradicionaleve - radioja, televizioni, gazetatat, magazinat, janë media të cilat ende kanë potencial që ta sigurojnë komunikimin e iniciativave qytetare, të organizatave me grupet e tyre të targetuara dhe me opinionin më të gjerë. Me mediat tradicionale, veçmas me televizionin, arrihet përfshirja e një publiku më të madh se sa ajo çka mund të bëhet vetëm me aktivitetet programore. Komunikimi i vazhdueshëm dhe shkëmbimi i informacioneve e ndihmon koordinimin e aktiviteteve me partnerët dhe siguron hapësirë për përfshirjen e partnerëve të rinj në iniciativë (Doracak për qytetari aktive, Форум – Центар за стратешки истражувања и документација, Shkup, 2015:112).

Përmes mediave, sigurohet informimi i domosdoshëm i të gjitha grupeve kulturore me institucionet shtetërore, organizatat joqeveritare, etj. Ekzistenca e këtij nyjelidhësi është i pranishëm në të gjitha etapat njerëzore, që nga koha më primitive, kur komunikimi bëhej me gdhendje të simboleve në gur, e deri te të ashtuquajturat media sociale, që sot mundësojnë shkëmbimin e informacionit në kohë reale në mënyrë të drejtpërdrejtë nga të gjitha cepat e botës. Mjafton që të kesh një aparat telefonik mobil i teknologjisë së re, të jesh i pajisur me internet, dhe komunikimi mundësohet në mënyrë efikase dhe të pandërprerë, qoftë me zë qoftë me video-lidhje të drejtpërdrejtë. Ky lehtësim i komunikimit, ka një rol të jashtëzakonshëm për njohjen e kulturave të ndryshme, dhe i paraprinë procesit të globalizimit, integritit të të gjitha grupeve kulturore mes kulturave më të mëdha që mbisundojnë në botë.

Megjithatë, jo gjithëherë mediat e kanë luajtur rolin e tyre të duhur, dhe në shumë raste ato janë bërë veglat më të këqija në duart e politikës, për të devijuar tërësisht misionin e tyre primar – informimin korrekt dhe të paanshëm për të gjitha grupet etnokulturore, gjuhësore, etj.

Komunikologu Sefer Tahiri vëren se: “Mediat në Ballkan pas viteve të 90-ta dëshmuar se posedojnë fuqi të madhe efektive që t'i ndajnë njerëzit në baza etnike, duke nxitur dhe inkurajuar konflikte mbi këtë bazë. Mediat masive në Evropën Juglindore ishin përplot me përmbajtje të cilat u bazuan mbi propagandën dhe gjuhën e urrejtjes ndaj të tjerëve, që konsideroheshin si armiq” (Tahiri, 2019:407). Në fakt, roli i mediave në ish-Jugosllavinë, së pari

në Serbi, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe më vonë edhe në Kosovë e Maqedoni, në shumë raste shkonte në drejtim të nxitjes së urrejtjes deri në vrasje midis fqinjëve më të afërt.

Në bashkësitë shoqërore multietnike dhe multikulturore, siç është Republika e Maqedonisë, çdo strukturë e saj duhet të reflektojë ndjenjë adekuate të përgjegjësisë për funksionimin e kësaj bashkësie. Kështu duhet të jetë edhe kontributi i mediave. Sipas analizave të organizatave profesionale, të esanfit dhe ndërkombëtare, mediat në Maqedoni në vitet e fundit përballen me një krizë të thellë profesionale dhe etike (Çausidis, Bojarovski, 2012:4). Në një nga hulumtimet e fundit të Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtarë lidhur me besimin e qytetarëve ndaj disa institucioneve dhe veprimtarive në Maqedoni, tregon se numri i qytetarëve që nuk u besojnë mediave arrin në 70 për qind. Qasja gazetareske me të cilat mediat i prezantojnë grupet e caktuara shoqërore, mënyra se si fokusohen ose i përshkruajnë dukuritë negative dhe proceset, mund hapur ose në mënyrë suptile të nxisë stereotipa, etnocentrizëm, ksenofobi dhe gjuhën e urrejtjes, nënvizohet në një “Doracak për etikën në gazetari”, përgatitur nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë në Shkup, 2012.

Rrjedhimisht, edhe në vendin tonë shënohen praktika të përditshme të cilat nuk janë në funksion të mirëqenies së përgjithshme të kulturave të ndryshme që bashkëjetojnë nën një qiell të përbashkët. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut kemi media të cilat kanë bërë programe paralele dygjuhësore (shqip, maqedonisht), si Tv Alsat, Tv 21, etj., dhe në anën tjetër kemi media maqedonase cilat aspak nuk lënë hapësirë për gjuhën shqipe, të cilat e flasin më tepër se 25% e popullatës. Media të tilla njëgjuhësore dhe njëetnike, janë p.sh. mediat kryesore televizive maqedonase, si Tv Sitel, Kanal 5, Telma, Alfa, etj. Për dallim nga to, transmetuesi publik radioteleviziv (RTM), ka program të veçantë në gjuhën maqedonase, shqipe dhe në gjuhët e pesë bashkësive tjera etnike që jetojnë në vend. Prania e elementeve multikulturore brenda programeve të këtyre mediave, është çështje e cila kërkon një studim të veçantë dhe më të thelluar.

Në misionin e tyre për informim të drejtë dhe saktë multikulturor, mediat duhet të gjejnë mbështetjen e duhur, si të sipërmarrësit privat, po ashtu edhe te fondet e ndryshme ndërkombëtare, meqë jo gjithëherë mediat mund të sigurojnë ekzistencën e tyre përmes

audiencës, marketingut apo shitjes (në rastin e gazetave). Prandaj, domosdoshmërisht vjen në shprehje edhe mbështetja institucionale apo shtetërore, e cila jo vetëm se duhet të sigurojë ekzistencën e mediave, por edhe duhet të sigurojë pavarësinë e tyre editoriale, veçanërisht kur janë në pyetje politikat multikulturore në shtetet dhe shoqërinë e tilla, pra multikulturore. Një analizë e OSBE-së në Vjen, thekson faktin se: Mbështetja nga ana e qeverisë gjithkund është e rëndësishme parësore për mbijetesën e mediave në gjuhë të ndryshme.

Ndërhyrja arrogante e sistemeve shtetërore kundër politikave multikulturore ka qenë gjithmonë prezentë, që nga shoqëritë totalitare e deri te shtetet e sotme, madje që janë edhe anëtare të Bashkimit Evropian. Një rast i tillë dhe shumë aktual kohën e fundit që kundërshton multikulturalizmin dhe liberalizmin perëndimor, është situata me Hungarinë, e cila udhëhiqet nga një qeveri konservatore (Raportuesja e Posaçme e OKB-së për Çështje të Lirisë së Mendimit dhe Shprehjes Irene Khan).

Raste të tilla si në Hungari ka të shumta, dhe ato janë shembull shumë i keq i zhvillimit të mediave dhe krijimit të një komunikimi të shëndoshë multikulturor brenda shoqërive respektive.

2.6. Roli i shoqërisë civile në kohezionin e shoqërive multikulturore

Shoqëritë civile kaherë kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në kohezionin dhe në stabilitetin shoqëror, në zhvillimin e koncepteve demokratike dhe multikulutore, veçanërisht në shtetet apo në përgjithësi në shoqëritë multientike dhe multikulturore. Kontributi i tyre është i një rëndësie të veçantë në ngritjen e kapaciteteve shtetformuese, por edhe në ngritjen e vetëdijes kulturore brenda grupeve të ndryshme etnike, gjuhësore, racore, religjioze, etj.

Në fillim mbase mund të mendohet, se pjesë e shoqërisë civile janë të gjithë ata njerëz, të cilët kanë paraqitje civile, pra nuk mbajnë „uniformë“; Pra persona, që nuk kanë asnjë lidhje me shtetin ose me institucionet e tij. „ Por me fjalën „uniformë“ kuptohet, që njerëzit me uniformë kanë të njëjtën paraqitje, mendojnë njësoj apo duhet të përmbushin të njëjtat detyra. Nga ana tjetër personat „pa uniformë“ mund të shikohen si individë, të cilët janë të pavarur dhe mund të mendojnë dhe veprojnë të lirë” (Hantke, XX:2). Në fakt, në ish-shtetet diktatoriale, nuk ka pasur tolerancë për personat që nuk kanë pasur uniformë, prandaj tek to edhe nuk njihet e kundërta e një „shoqërie me uniformë“, pra „shoqëria civile“, e cila si shprehje edhe nuk ka gjetur përdorim të përditshëm.

Për shkak të ndikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), është evidentuar një formë e re e angazhimit qytetar, me impakt të gjerë në format e bashkëpunimit për arritjen e qëllimeve shoqërore. Gjysma e popullsisë në botë, deri në fund të vitit 2017, ose rreth 3,819 miliardë njerëz, vlerësohen përdorues aktivë interneti, tre miliardë prej të cilëve vlerësohen si përdorues aktivë të mediave sociale.(OSBE, Vjenë, 2018:18) Në të vërtetë, ky lloj revolucioni teknologjik mundësoi shtrirje globale të mediave sociale, me pjesëmarrje të personave nga vende të ndryshme të botës, kultura të ndryshme dhe realitete të ndryshme politike. Këto lloje të mediave të reja, kanë mundësuar një komunikim jashtëzakonisht të shpejtë me publikun e gjerë.

Tek ne në Ballkan, në emër të shoqërisë civile zhvillojnë aktivitete të ndryshme shoqatat joqeveritare, të cilat kanë filluar veprimtaritë e tyre sidomos pas përmbysjes së regjimeve komuniste në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar. Që nga ajo kohë kanë vërshuar shoqata të shumta, si nga bota perëndimore, po ashtu edhe ajo lindore, duke investuar në projekte të shumta që stimulonin diversitetin në të gjitha pikëpamjet e mundshme.

Në Maqedoni organizatat e mjedisit u krijuan në fund të viteve 80-ta, organizatat humanitare në fillimin e viteve 90-ta (si rezultat i krizave ekonomike dhe krizave të refugjatëve nga ish-Jugosllavia) dhe organizatat e të drejtave të njeriut filluan të krijoheshin në mes të viteve 90-të. Gjatë periudhës 1990-1998 ishin rreth 3,295 organizata të reja të shoqërisë civile të regjistruara.

Në Maqedoninë e Veriut dhe rajonin e gjerë, një sërë shoqatash joqeveritare zhvillojnë veprimtari të shumta në të gjitha polet e veprimtarive shoqërore. Ato rëndomë janë regjistruar nëpër organet shtetërore, më parë nëpër gjykatat themelore, ndërsa më pas në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si organ i veçantë shtetëror që merret me rregullimin e veprimtarive të shoqatave dhe fondacioneve qytetare, për të cilat ekziston edhe një ligj i veçantë, që quhet Ligji për shoqata dhe fondacione, i miratuar në vitin 2010. (Shih: Ligj për shoqata dhe fondacione, Службен весник на РМ, бр.52/2010 од 16.04.2010). Në këtë kuadër ligjor janë të regjistruar me dhjetëra e qindra shoqata qytetare, në mesin e të cilave një numër i kënaqshëm bëjnë pjesë në korpusin e shoqatave që merren me çështje të multikulturalizmit. Duke qenë se vendi ynë është multietnik dhe multikulturor, si edhe shumë shtete tona përreth, shumë projekte ndërkombëtare i stimulojnë këto tematika, prandaj edhe numri i tyre është gjithnjë e më i madh. Në këtë plan, shumë projekte të tilla multikulturore, kanë kontribuar në përafrimin e grupeve të ndryshme etnike e religjioze në vend dhe në krijimin e një klime mirëbesimi në mes komuniteteve, veçanërisht pas periudhës së konfliktit luftarak të vitit 2001, kur pati një përleshje të hapur të armatosur mes shqiptarëve dhe maqedonasve.

Kur jemi te kontribuesit dhe mbështetësit e projekteve multikulturore, me qëllim të krijimit të një kohezioni më të fuqishëm shoqëror ndërmjet komuniteteve, vlen të theksohet se rajonin tonë në përgjithësi, më së shumti ka kontribuar Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni, pjesë e rrjetit global të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapura, të themeluara nga investitori dhe filantropi amerikan, Xhorxh Soros (Për më tepër, shih në: <https://fosm.mk>). Ky fondacion në Maqedoni zyrtarisht ka filluar me punë në vitin 1992, pra me ndryshimet e para demokratike të vendit. Sipas të dhënave që ofrohen Fondacioni ka investuar më shumë se 100 milionë dollarë për demokratizimin e shoqërisë në Maqedoni dhe për përmirësimin e jetës së qytetarëve të saj. Nga mbështetësit e tjerë të projekteve të tilla multikulturore janë edhe agjencia gjigante amerikane USAID, e cila po ashtu mbështet edhe Maqedoninë e Veriut në përpjekjet për përforcimin e praktikave dhe institucioneve demokratike, rritjen e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit (Për më tepër, shih në: <https://www.usaid.gov>). Ndër mbështetësit e tjerë shumë të rëndësishëm në këtë fushë bëjnë pjesë edhe: Agjencia Turke për

Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), etj. Gjithashtu, edhe vetë institucionet shtetërore stimulojnë realizimin e vetëdijes shoqërore multikulturore, përmes projekteve që ndahen nga Qeveria, ministritë dhe drejtoritë e ndryshme, si pjesë e angazhimeve dhe përgjegjësi të tyre qytetare.

Njësia për bashkëpunimin me organizatat joqeveritare është krijuar në dhjetor 2004 brenda Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Maqedonisë dhe sektorëve të tij për analizën e politikës dhe koordinimin. Njësia u krijua me qëllimin për të krijuar një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë. Njësia ka qenë e përfshirë në zhvillimin e Strategjisë të Bashkëpunimit mes qeverisë dhe sektorit të shoqërisë civile. Qëllimi i strategjisë është “rritja e ndërgjegjësimit dhe krijimi i partneritetit ndërmjet qeverisë dhe organizatave civile si dhe të rrisë transparencën në procesin e krijimit të politikave”(Michieli, Mesari, 2007:105-106). Gjithashtu ajo synon vendosjen e rrjetit funksional i cili lehtëson komunikimin dhe koordinimin e zhvillimit të sektorit civil – ndërmjet shtetit dhe autoriteteve të tjera administrative. Njësia gjithashtu synon arritjen e një bashkëpunimi të fuqishëm ndërinstitutional. Sipas strategjisë, ministritë caktojnë një person përgjegjës për të zhvilluar bashkëpunimin midis ministrive përkatëse dhe organizatave të shoqërisë civile si dhe të bashkëpunojnë dhe me autoritetet e tjera shtetërore. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe sektorit civil ekziston edhe në nivele lokale. Kështu, disa komuna kanë punësuar persona të shoqërisë civile që janë përgjegjës për realizimin e bashkëpunimit me shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet, si dhe jepet një mbështetje e vogël financiare për projekte të caktuara, veçanërisht nga sfera e kulturës, arsimit dhe jetës sociale.

Besimi dhe opinioni publik për shoqërinë civile janë një nga parakushtet për përfshirjen e qytetarëve në shoqërinë civile. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, besimi në shoqërinë civile është i ndarë dhe në rënie, ndërsa përfshirja e qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile është relativisht i ulët. Ndërsa numri më i madh qytetarëve e perceptojnë shtetin si më të përgjegjshmin në zgjidhjen e nevojave sociale, arsyet janë motivimi i dobët për kyçjen e tyre si në veprimtari politike jopartiake ashtu edhe në organizatat e shoqërisë civile. Këto janë disa nga konkluzat e një projekti të realizuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN - MCMC), ku janë përfshirë rreth 9.000 organizata qytetare në vend (Shih më tepër në:

<https://mcms.mk/sq/lajme-dhe-opinioni/fjalime/1268-1011irg302-istrazuwanja-za-gragjanskoto-opstestvo-ir.html>. Shikuar më 29.08.2022).

Përfshirja më e madhe e shoqërisë civile në proceset e bërjes së politikave dhe reformave shoqërore e shtetërore, nuk ndodh automatikisht. Ka shumë forma se si shoqëria civile mund ta etablojë zërin e saj në politikëbërje dhe vendimmarrje, duke imponuar zgjidhje të drejta dhe të mirëqena për zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëror, gjithnjë duke pasur parasysh respektimin e realitetit multikulturor në vend. Republika e Maqedonisë së Veriut ka nevojë shumë më tepër për zërin qytetar, për të krijuar një ambient stabil social multikulturor, ku do të respektoheshin njëtrajtshëm të drejtat dhe obligimet e gjithsecilit pjesëtar të këtij shteti.

3. PJESA E TRETË

3.1. Impakti i multikulturalizmit në zgjidhjen e problemeve shoqërore

Vlerësimi dhe zbatimi i drejtë i politikave multikulturore, rëndomë ka çuar në zgjidhjen e shumë problemeve shoqërore, edhe në shoqëritë e acaruara, qoftë për shkak të dallimeve gjuhësore, racore, kulturore e të ngjashme. Prandaj, impakti i multikulturalizmit, pa dyshim që ka kontribuar shumë në zgjidhjen e shumë problemeve, në fashitjen e dallimeve dhe në ecjen përpara të shoqërive të reja dhe demokratike.

Në këtë aspekt, mund t'i marrin shembull vendet nga ku e pati burimin vetë koncepti i multikulturalizmit, SHBA-ja e Kanadaja, të cilat duke qenë vende shumë heterogjene në kuptim të përbërjes së tyre demografike, të krijuar kryesisht nga emigracioni gati se i pakontrolluar, në fillimet e tyre patën probleme të jashtëzakonshme deri në zbutjen e dallimeve. Të përkujtojmë se problemet më të mëdha në këto vende, dhe veçanërisht në SHBA, lidhen me racizmin, e që në momente të caktuara shpeshherë përsëriten, duke shkaktuar reagime të mëdha në opinion. Në maj 2020, SHBA-në e tronditi vdekja e afrikano-amerikanit George Floyd, i cili ishte i arrestuar nga një polic i bardhë të Mineapolisit, të cilit i vuri gjurin në qafë për disa minuta. Menjëherë pasi filloi të qarkullonte videoja e arrestimit të Floyd, u shkaktuan protesta globale. Miliona vetë, fillimisht kryesisht me ngjyrë, u bashkuan në protesta, përfshirë të bardhë dhe të ngjyrave të tjera duke kërkuar ndaljen e racizmit dhe të përdorimit të forcës së tepruar nga policia amerikane. Të rinjtë amerikanë të të gjitha racave dhe kulturave, kanë qenë në rreshtin e parë të këtyre protestave, duke treguar solidaritet me viktimën e racizmit të dhunshëm që u ushtrua nga një oficer policie (Shih: Derek Chauvin dënohet për shkeljen e të drejtave civile të afrikano-amerikanit George Floyd: Zëri i Amerikës <https://www.zeriamerikes.com/a/6649740.html>. Shikuar më 29.08.2022).

Reagimi i ashpër qytetar në një rast të vetëm të krimit që u lidh me shprehje të racizmit në vendin kulmor të demokracisë botërore, SHBA, tregon se sa është ngritur vetëdija e përgjithshme qytetare e amerikanëve, të cilët pavarësisht dallimeve që kanë mes vete, në pjesën më të madhe e respektojnë vlerat e ndryshme kulturore të njëri-tjetrit. Kësaj shoqërie i vije në ndihmë edhe kushtetuta dhe shteti i së drejtës, i cili ka mekanizma të sanksionimit të atyre që shkelin limitet e caktuara, përkatësisht të drejtat dhe liritë e njeriut, pavarësisht përkatësisë etnike, gjuhës, racës, orientimit seksual, gjinisë, moshës, etj.

Ndërkohë, këtu po përmendim edhe një rast më eklatant që ndodhi vite më parë në Evropë, konkretisht në Norvegji. Më 22 korrik 2011, ekstremisti Anders Behring Breivik, 32 vjeçar, vrasës i 77 njerëzve të pafajshëm, ka thënë para gjykatës se „vrasjet ishin „të nevojshme” për ta shpëtuar Norvegjinë dhe Evropën nga islamizmi dhe multikulturalizmi” (<https://www.evropaelire.org/a/24390624.html>. Shikuar më 29.08.2022). Breivik u dënua 21 vjet burg, me pretendimin se në momentin e aktit nuk ishte në gjendje të mirë mendore, mirëpo akti i tij kriminal u dënua forcërisht nga e gjithë bota demokratike, megjithëse dëmi i veprës së tij ishte shumë i madh, meqë u dha krahë qarqeve të caktuara të antiislamizmit dhe antimultikulturalizmit në Evropë dhe gjetiu. Pra, ky akt i shëmtuar ndodhi në Norvegji, pikërisht në një vend të njohur për një demokraci moderne dhe një sistem mirëqenie shumë të zhvilluar. Norvegjia është një shoqëri multikulturore dhe e larmishme për nga diversiteti etnik e fetar, i cili kohezionin e vetë shoqëror e ka gjetur pikërisht në respektimin e plotë të vlerave multikulturore që kanë sjellë kryesisht emigrantët kryesisht nga pjesë të ndryshme të Evropës Lindore dhe Juglindore.

Kuptimi i vërtetë i vlerave multikulturore, sjell deri te zgjidhja më e lehtë e shumë problemeve mes komuniteteve divergjente. Duke pranuar tjetrit siç është, me të gjitha ‘të mirat’ dhe ‘të këqijat’ e tij, shoqëritë bashkëkohore më lehtë ballafaqohen me dallimet gjithnjë e më shumë në rritje, që janë karakteristike e shoqërive të sotme në epokën e globalizimit. Në këtë rast, edhe vetë politikat tona shtetërore gjithnjë e më shumë po u përshtaten koncepteve multikultualiste dhe interkulturaliste, meqë kjo frymë gjithnjë e më tepër është e pranishme në mesin tonë. Emigracioni gjithnjë e më shumë në rritje, stimulon nevojën e ridimensionimit të shoqërive tona, të cilat po përballen gjithnjë e më tepër me diversitet të të gjitha llojeve.

Në fakt, multikulturalizmi kërkon përfshirjen e pikëpamjeve dhe kontributeve të anëtarëve të ndryshëm të shoqërisë duke ruajtur respektin për dallimet e tyre dhe duke penguar tendencat për asimilimin e tyre në kulturën dominuese. Një nga përfitimet kryesore të të jetuarit në një shoqëri multikulturore është se shkëmbimi kulturor i ideve, vlerave dhe zakoneve mund t'i ndihmojë njerëzit të zgjidhin më lehtë problemet e tyre bashkërisht të të gjitha natyrave të mundshme dhe të rrisin cilësinë e jetës së tyre.

Nëse një grup më i madh etnik apo gjuhësor kërkon të drejtën që i takon sipas ligjit dhe kushtetutës, ajo duhet respektuar në maksimum, të mos ketë ndasi ndërmjet popullatës vendore, ku gjithë të njihen të barabartë duke respektuar njëloj ligjin e atij shteti. Kjo gjë fatkeqësisht deri më tani në shumë raste ka munguar, si pasojë e një papërgjegjësie të elitave politike, të cilat për shkaqe populiste, shpeshherë kanë pasur qëndrime jo të drejta dhe të paarsyeshme për një shoqëri evropiane multikulturore.

Po t'i kthehemi edhe njëherë vendit tonë, Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të shohim se në periudha të caktuara, ka pasur incidente ndëretnike dhe mosmarrëveshje mes maqedonasve dhe shqiptarëve kryesisht për çështje etnike, gjuhësore e religjioze. Rrahjet mes nxënësve shqiptarë dhe maqedonas nëpër shkolla dhe autobusë ishin të shpeshta, sikurse edhe sulmet e të rinjve nëpër qendrën e Shkupit, përleshjet mes tifozëve në ndeshjet sportive – që ishin të shpeshta e 'të zakonshme', etj. Për këtë, në raste të caktuara janë bërë edhe hulumtime të politikave publike, duke u detektuar problemet kyçet në shoqërinë tonë multikulturore.

Pra, mosbesimi ndaj institucioneve është rezultat i një politke të keqe sepse çdo incident dhe dhunës mes të rinjve e etiketojnë me prapavijë etnike ose fetare. Gjendja mund të përmirësohet nëse vërtet ekziston angazhim serioz i të gjithë faktorëve relevant në shtet. Por në fakt, njohja sistematike me kulturat e njëri tjetrit, bëhet kryesisht përmes arsimit, zbatimit të standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave kombëtare, me masa ligjore kundër ndasive etnike, etj. Të gjitha këto masa ndikojnë në forcimin dhe zbatimin e multikulturalizmit në vend. Por mungesa e këtyre masave nga vetë shteti, ka bërë që shpeshherë të del situata nga kontrolli, andaj disa herë për gjendje të tilla kanë reaguar me shqetësim edhe ambasadorët e shteteve më të fuqishme të botës që janë të vendosur në vendin tonë.

Në këtë mes janë edhe rezultatet e hulumtimeve të shumta shkencore që janë bërë me hulumtimin e opinionit publik, ku „86% nga 300 të anketuar në kuadër të hulumtimit “Sjellja etike e të rinjve në një mjedis multikulturor” i realizuar gjatë vitit 2019 nga Instituti Maks Van Der Stoel i Universitetit të Evropës Juglindore dhe Instituti për Hulumtim, Inovacion dhe Zhvillim, janë shprehur se politika ndikon që të rriten ndasitë mes etnive të ndryshme, kurse 49.3% prej tyre si faktor kryesor për këtë, konsiderojnë se janë rrjetet sociale” (<https://portalb.mk/650300-hulumtim-ne-rmv-86-e-qytetareve-mendojne-se-politika-ndikon-qe-te-rriten-ndasite-mes-etnive/>. Shikuar më 30.08.2022). Ndërsa, në pyetjen se a mund të gjitha etnitetet të bashkëjetojnë në Maqedoni, 88,7% e të anketuarve kishin mendim pozitiv Pjesëmarrësit në këtë hulumtim, ishin nga rajoni i Pollogut, gjegjësisht qytetet si Tetova dhe Gostivari dhe vendbanimet që gravitojnë përreth.

Por derisa në hulumtimin e mësipërm, të zhvilluar kryesisht në rajone shqiptare, siç është ai i Pollogut, shumica (afër 90%) kanë mendim pozitiv për bashkëjetesën, çuditërisht një vullnet të kundërt hasim vazhdimisht tek të gjitha anketat që bëhen me qytetarë të përkatësisë etnike maqedonase. Kështu për shembull, bazuar në një anketë dhe hulumtim tjetër shkencor të realizuar vite më parë në gjithë territorin e Maqedonisë, shifrat janë dëshpëruese. Në pyetjen, nëse ekzistimi i disa grupeve etnike në Maqedoni është pasuri për shtetin, pozitivisht janë përgjigjur 77% e të anketuarve, ndërsa me negativisht 23%. Por, sa i përket përkatësisë etnike të të anketuarve, shihet se shqiptarët kanë një variabël shumë më të lartë të përqindja e përgjigjeve pozitive, në raport me maqedonasit. Në fakt, përqindja e maqedonasve që mendojnë ashtu (pra, negativisht për multietnicitetin e shtetit) rritet vazhdimisht, dhe në vitin 2012 kishte arritur shkallën më të lartë deri në 70%. (Atanasov, 2012:68). Pra gjithçka varet nga aktorët kryesorë politikë se si pozicionohen karshi proceseve të rëndësishme demokratike të vendeve tona.

Në mesin e shumë problemeve që ndërlidheshin parasëgjithash me çështjet etnike dhe gjuhësore në Maqedoni, ishin ato të arsimit shqip. Në shekullin e kaluar të viteve ‘90-ta mbyllën shkollat e mesme në shumë qytete të Maqedonisë, si në Kumanovë, Shkup, Kërçovë, etj., e mos

të flasim për hapjen e universitetit në gjuhën shqipe. Si rezultat i atyre kundërshtimeve, në vitin 1994 u hap Universitetit i Tetovës me mësim në gjuhën shqipe, i cili për shtetin ishte ilegal.

Për tejkalimin e mosmarrëveshjeve të nivelit ndëretnik dhe ndërkulturor në Maqedoni, dhe në shenjë të respektimit të vlerave multikulturore të vendit, duke iu mundësuar edhe shqiptarëve të shkollohen institucionalisht në gjuhën e tyre amtare në nivelin sipëror, në vitin 2000 u themelua Universiteti i Evropës Juglindore (South East European University), me seli në Tetovë.

Në të vërtetë, në pranverën e vitit 2000, i përkrahur nga donatorë ndërkombëtarë, Komisionari i lartë i OSBE-së për pakicat nacionale, Max van der Stoep, inicioi diskutimet për themelimin e një universiteti të ri në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

„Pas miratimit të Ligjit për Arsim të Lartë, nga Parlamenti i Maqedonisë së Veriut, i cili lejoi krijimin e universiteteve nga themelues që nuk kanë të bëjnë me shtetin dhe i cili përkrahu mësimin në gjuhën shqipe, filloi planifikimi i krijimit të universitetit në fund të vitit 2000. Ndërtimi filloi në mars të vitit 2001 dhe Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) u hap gjashtë muaj më vonë”. (Historiku i UEJL: <https://www.seeu.edu.mk/sq/about/history>. Shikuar më 30.08.2022). Interesimi i studentëve për t’u regjistruar në këtë universitet ishte shumë i madh, gjë që dëshmohet me rritjen e numrit të studentëve nga viti në vit. Nëse „në nëntor të vitit 2002, numri i studentëve ishte 2.250, ndërsa në tetor të vitit 2003, numri i studentëve arriti në 3.700. Që nga themelimi, në tetor të vitit 2001, ka arritur ta dëshmojë veten si universitet lider i cilësisë, financiarisht i qëndrueshëm dhe tashmë i marrë si model i arsimit të lartë shumëtnik dhe shumëgjuhësor në Evropën Juglindore” (Historiku i UEJL: <https://www.seeu.edu.mk/sq/about/history>. Shikuar më 30.08.2022). Pra, ky universitet në të cilin janë të përfshirë pa dallime të gjitha komunitetet që jetojnë në vend, u bë një nga shembujt më pozitivë në Maqedoninë e trazuar, për zgjidhjen e problemit të arsimit të lartë të shqiptarëve.

Nëse dalim në rajon, një shembull shumë pozitiv drejt zgjidhjes së problemeve ndëretnike apo ndëreligjioze përmes mekanizmave kushtetues, është rasti me shtetin më të ri evropian – Kosovës. Në përputhje të plotë me rekomandimet e të dërguarit të posaçëm të OKB-së Martti Ahtisaari. Kuvendi i Kosovës e adoptoi deklaratën e shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008.

Ku Kosova u shpall një shtet demokratik, sekular dhe republikë multietnike dhe i pranonte plotësisht obligimet e Kosovës sipas planit të Ahtisarit. Në bazë të atij postulati multikulturor, funksionin tash normalisht Republika e Kosovës, duke i respektuar në maksimum të drejtat dhe liritë etnike, gjuhësore, fetare e racore të të gjitha etniteteve që e përbëjnë këtë shtet. Gjuha serbe njihet si gjuhë zyrtare në Kosovë, krahas shqipes, prandaj gjen zbatim të plotë në institucionet vendore dhe qendrore, shenjat e rrugëve, shesheve e bulevardeve në Kosovë janë shënuar shqip dhe serbisht. Ndërsa, serbët e Kosovës kanë edhe të drejtën e shkollimit të tyre në të gjitha nivelet në gjuhën e tyre amtare, ashtu siç kanë të drejtë arsimimi edhe pjesëtarët e pakicave të tjera në këtë shtet të ri, siç janë turqit, romët, ashkalinjtë, etj.

Me këtë rast, do të përkujtojmë deklaratën e ish-Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili gjatë një takimi me anëtarët e Këshillit Konsultativ për Komunitete, kishte deklaruar: “Kosova është shembull se si duhet të promovohet dialogu dhe si duhet të ndërtohet një shtet që është shtëpi e të gjitha komuniteteve, me një shoqëri multikulturore, ku të gjithë, pa dallim përkatësie etnike, do të mund ta ruajnë dhe ta kultivojnë identitetin dhe kulturën e tyre” (<https://www.evropaelire.org/a/27727917.html>. Shikuar më 30.08.2022).

Modeli i Kosovës në zgjidhjen e problemeve brenda komuniteteve, është jashtëzakonisht efektiv në zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve brenda komuniteteve të ndryshme që jetojnë nëpër pjesët tjera të rajonit dhe botës. Pra, mundësia që brenda shtetit dhe komunitetit të gjerë, secili të ndihet si në shtëpinë e vetë, duke zbatuar dhe respektuar të gjitha traditat kulturore që lidhen me origjinën etnike a fetare, është çelësi i një suksesi të një politike multikulturore. Problemet që shpeshherë shohim në ekranet televizive në Kosovë, me serbët e veriut në vend, lidhen nga ndikimet e drejtpërdrejta të elitës politike serbe të Kosovës me elitën politike serbe të Beogradit, të cilët provokojnë situata ndëretnike me qëllime politike apo kriminale, se për ndryshe, serbët e Kosovës i gëzojnë ligjërisht dhe institucionalisht të gjitha të drejtat e tyre kulturore, kombëtare e fetare, sikurse të gjithë qytetarët e tjerë të këtij shteti multietnik.

3.2. Sfidat dhe perspektivat e multikulturalizmit

Në kohën e ndryshimeve të mëdha globalizuese nëpër të cilën po kalon shoqëria e sotme, njeriut bashkëkohor i dalin para sfida të shumta. Veçanërisht ndaj shoqërive multikulturore, shtohen problemet si rezultat i zhvillimeve lidhur me konfliktet e luftërave në rajon dhe botë, cilat bëhen shumë të afërta për secilin individ, si rezultat i shpejtësisë së madhe të informacioneve që sot qarkullojnë në kohë reale nga një skaj i botës në skajin tjetër. Ta zëmë, një problem që prekë probleme me karakter multikulturorë (etnike, fetare apo racore) që shfaqet në skajin e SHBA-së apo Evropës, brenda pak orëve kaplon gjithë globin (rasti i përmendur më herët me G. Floyd), përmes mediave sociale që kanë marrë pushtet të madh dhe gjithnjë e më tepër janë në zhvillim dhe rritje e sipër.

Siç kemi theksuar, multikulturalizmi herë-herë ka pasur reagime edhe nga ish-drejtnesit e shteteve më të mëdha evropiane (Merkel, Kameron, Sarkozy, etj), këtë koncept e kanë shpallur ‘të pasuksesshëm’, si shkak kryesor pazotësia e emigrantëve myslimanë në vendet e tyre që nuk donin të integroheshin në shoqëritë e tyre dhe që nuk e pranuan identitetin e kombit ku migruan?! Pra, multikulturalizmi ka para vetes një sërë sfidash me të cilat ndeshet çdo ditë në shoqëritë bashkëkohore, pikërisht për shkak të diversitetit gjithnjë e më të madh etno-kulturor, që shkaktohet nga migrimet e shpeshta nga një skaj në skajin tjetër të botës.

Vite me radhë Evropa perëndimore është ballafaquar me flukse të mëdha emigrantësh që vijnë nga vendet e Lindjes, ku vite me radhë pati luftime të ashpra, si në Afganistan, Siri, Irak e gjetiu. „Perspektiva e më shumë refugjatëve afganë në kufijtë e tyre ka nxitur shtete të Evropës Qendrore, ato baltike dhe ballkanike që të përfundojnë barrierat e planifikuara dhe gardhe me tela në kufi”(<https://www.zeriamerikes.com/a/6214372.html>. Shikuar më 31.08.2022). Në muajin gusht 2021, Shteti Grek përfundoi murin prej 40 kilometrash përgjatë kufirit tokësor me Turqinë ku instaloi sistem të automatizuar vëzhgues për pengimin dhe arritjen e azilkërkuesve në Evropë.

Realisht problemi me emigracionin e madh që vjen vazhdimisht viteve të fundit nga vendet lindore arabe – myslimane, paraqet sfidën më të madhe për suksesin apo dështimin e konceptit

të multikulturalizmit për Evropën me shumicë të popullsisë së krishtere dhe me ngjyrë të bardhë. Kur kësaj i shtohet kriza e madhe ekonomike – financiare që po ndodhë pas krizës shëndetësore globale me pandeminë Covid-19, atëherë problemet mund të jenë edhe më të mëdha. Mënyra se si do të sillen elitat politike me këtë fluks emigrantësh të rinj, është e një rëndësie thelbësore për suksesin apo dështimin e multikulturalizmit në Evropë dhe rajon.

Në anën tjetër, emigracioni në rritje duhet kuptuar edhe si hap pozitiv për vendet në Evropën perëndimore, duke qenë se pjesa e konsiderueshme e këtyre emigrantëve përbëjnë një fuqi të madhe punëtore mjaft profesionale, e cila do t'i del në ndihmë shtimit të qëndrueshmërisë ekonomike, e veçanërisht sektorit të teknologjisë informative, ku një pjesë e madhe e tyre janë jashtëzakonisht të përgatitur profesionalisht.

Një numër teoricienësh pajtohen se një nga parakushtet themelore për zbatimin e multikulturalizmit, është toleranca. Toleranca është një predispozitë themelore e shoqërisë civile. Në të njëjtën kohë, toleranca nuk duhet kuptuar si inferioritet dhe mosinteresim ndaj të ndryshmit, që duhen duruar, por si vetëzotërim dhe kujdes ndaj tjetrit. Sjellje tolerante ndaj “tjetrit” dhe të “ndryshmit”, nënkupton edhe “dialog” me “ata që janë pranë nesh”. Dialogu i referohet shkëmbimit të kulturave, të marrjes - dhënies së ndërsjellë, që është një nivel shumë më i lartë se toleranca. Në Maqedoni dhe në Ballkan ka një numër të madh shembujsh të dialogut solid dhe tolerancës së njerëzve nga kultura të ndryshme. Parimi i respektit të ndërsjellë është elementi thelbësor i bashkëjetesës në këto hapësira. Komunikimi i drejtpërdrejtë, i cili ndërton marrëdhëniet e besimit dhe fqinjësisë së mirë në nivel individual edhe në bazë të karakteristikave personale, dhe jo për shkak të të drejtave të komunitetit sipas sistemin juridik (Јанев, 2005:97-110).

„Promovimi i dialogut si mekanizëm i duhur në gjetjen e zgjidhjeve për mosmarrëveshjet bilaterale, apo i komunikimit si mjet për ndërtimin e urave të bashkëpunimit, kanë dëshmuar jo vetëm efikasitetin e tyre për vendet e rajonit, por kanë provuar se janë të vetmet alternativa për adresimin e përbashkët të agjendës evropiane” (<http://www.ambasadat.gov.al/united-kingdom/sq/ballkani-perendimor-perspektivat-integruese-dhe-sfidat>. Shikuar më 31.08.2022). Intensifikimi i dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së dhe SHBA-së, ka për qëllim normalizimin e raporteve ndërmjet këtyre dy shteteve të cilat vite më parë ishin në

luftë. Njohja reciproke mes tyre do të thotë hapje e perspektivave evropiane dhe një shans më tepër për respektimin e realiteteve multikulturore që mbizotërojnë si në Kosovë, po ashtu edhe në Serbi. Pra, për të siguruar një ardhmëri më të ndritshme të respektit të ndërsjellë mes kulturave dhe komuniteteve të ndryshme në rajon dhe në sistemin ndërkombëtar, nevojitet më shumë investim në njohjen vlerave të ndërsjella multikulturore.

Hapja më e madhe në kohën e fundit e shteteve të rajonit drejt këtyre vlerave multikulturore është një tregues i mirë për perspektivat e koncepteve multikulturore apo interkulturore. Një fat i mirë për rajonin tonë është hapja e negociatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë për aderim në familjen e madhe të Bashkimit Evropian në korrik të vitit 2022. Kjo i jep një shans më shumë rajonit tonë të përqafojë vlerat multikulturore evropiane, edhe si një detyrim shtesë për përmbushjen e kriterëve të duhura deri në anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian.

PËRFUNDIM

Shoqëria multikulturore është një shoqëri ku njerëzit e racave, kulturave dhe traditave të ndryshme jetojnë krah për krah me një respekt të ndërsjellë. Multikulturalizmi është i rëndësishëm për një shoqëri, sepse çdo shoqëri përbëhet nga njerëz me prejardhje etnike, kultura dhe fe të ndryshme që jetojnë dhe punojnë së bashku dhe flasin për një diversitet kulturor. Qasja më serioze për nevojat e grupeve të ndryshme etnike dhe realizimi i kërkesave të tyre për participimin më të madh në shoqëri, është një domosdoshmëri e pamohueshme.

Në këtë punim shkencor është shtjelluar koncepti i multikulturalizmit, si model i ri lehtësues në rajon dhe në sistemin ndërkombëtar. Konkretisht është shqyrtuar mundësia e tejkalimit të paragjytimeve brenda komuniteteve të ndryshme në shoqëritë tona multikulturore. Janë vërejtur rezultate të mahnitshme nga realizimi i dy anketave tona, nga ku janë marrë përvoja shumë të rëndësishme për hulumtimin tonë shkencor. Nga këto anketa është interesant të vihet re se sa ishin të thella dallimet mes komuniteteve të këtushme, sidomos në mes nxënësve, të cilët gati se nuk komunikojnë fare me njëri-tjetrin, duke qenë pjesëtarë të shoqërive heterogjene (maqedonase dhe shqiptare). Bashkëpunimi i tyre në një projekt multikulturor, bëri që të thyhen shumë barriera, përmes kuptimit real të vlerave të ndërsjella. Në fakt, rezultatet e arritura gjatë realizimit të dy anketave, në intervale të ndryshme kohore, tregojnë se vetëm përmes një bashkëpunimi konkret mes pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme (etnike, religjioze, racore), mund të vijmë deri tek njohja me njëri-tjetrin dhe mirëkuptimi për faktin që të gjithë jemi të ndryshëm dhe si të tillë duhet ta respektojmë tjetrin.

Më tej është provuar që koncepti i multikulturalizmit është model i ri lehtësues në rajon dhe në sistemin ndërkombëtar, përmes mekanizmave që promovojnë bashkëpunim të ndërsjellë, siç janë politikatat e mirëfillta multikulturore të Bashkimit Evropian, të cilat implementohen edhe në vendin tonë dhe vendet e rajonit të Ballkanit perëndimor. Bashkëpunimi më intensiv në planin ekonomik në mes shteteve dhe kulturave të acaruar historikisht ballkanike, sidomos mes

shqiptarëve, maqedonasve, serbëve, malazezëve, boshnjakëve, është një tregues shumë i mirë për afërsimin edhe në planin kulturor.

Në këtë punim janë studiuar edhe situatat me elemente tjera të veçanta të multikulturalizmit, siç janë: edukimi dhe arsimimi multikulturor, shumëgjuhësia në shoqëritë multikulturore, mediat dhe komunikimi multikulturor, roli i shoqërisë civile në kohezionin e shoqërive multikulturore, etj. Ndërsa, është shqyrtuar edhe impakti i multikulturalizmit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme shoqërore, si dhe sfidat dhe perspektivat e multikulturalizmit në të ardhmen.

Gjatë këtij hulumtimi, janë arritur disa përfundime që kanë dalë nga analiza e fakteve shkencore, anketave, intervistave me ekspertë, dhe gjendjes reale që pasqyrohet brenda shoqërive tona. Prandaj, mund të konkludohet se për të qenë koncepti i multikulturalizmit më efektiv brenda shoqërive tona, si një model lehtësues, është e nevojshme që:

- Të përforcohet edhe më shumë me përmbajtje të reja lënda e edukimit dhe arsimimit multikulturor apo interkulturor, përmes kurrikulave të veçanta në të gjitha etapat e shkollimit, në mënyrë që gjeneratat e reja të rriten me ndjenjën e respektit ndaj kulturave të tjetrit;

- Mediat informative dhe ato sociale duhet të kenë më tepër kujdes gjatë informimit dhe promovimit të vlerave multikulturore, duke iu shmangur paragjykimëve dhe stereotipave të ndryshme shoqërore që cilat sjellin ndasi dhe probleme ndërkulturore;

- Institucionet shtetërore dhe ato ndërkombëtare, duhet investuar më tepër në shoqërinë civile, përmes financimit të projekteve të ndryshme që nxisin multikulturalizmin dhe diversitetin, e që kanë impakt të madh në shoqëri;

- Institucionet politike në përdorimin e gjuhës së tyre gjatë komunikimit publik, duhet të jenë më të kujdesshëm në mënyrë që të mos nxisin dhunë dhe urrejtje mes kulturave të ndryshme;

- Në kohën kur vendi ynë, rajoni ballkanik dhe Evropa po ballafaqohet me një fluks në rritje të emigracionit nga Lindja, të kihet parasysh në mënyrën e edukimit, socializimit dhe etablimit të tyre brenda shoqërisë, duke i parë emigrantët si vlerë e shtuar e shoqërive tona;

-Diversitetin etnik, gjuhësor, fetar, racor, etj., duhet parë si një pasuri në tablon e gjerë të zhvillimit tonë shoqëror, duke përdorur maksimalisht potencialet e veçanta të secilës kulturë;

-Zhvillimi më i madh ekonomik, përmes bashkëpunimit të ndërsjellët të shteteve ballkanike, duhet t'i paraprijë edhe zhvillimit më të hovshëm ndërkulturor dhe multikulturor, etj.

Marrë në përgjithësi, pavarësisht skepticizmit në rritje edhe nga krerët e shteteve më të fuqishme evropiane, multikulturalizmi është një koncept mirë i etabluar brenda shoqërive tona ballkanike dhe evropiane, veçanërisht në këto tri dekadat e fundit. Prandaj, ka qenë një kohë e mjaftueshme për të kuptuar të gjithë se sa janë benfitet e kësaj politike për zhvillimin demokratik të shoqërive tona, më të avancuara dhe më të hapura drejt diversitetit faktik.

Fakti se gjitha vendet e Ballkanit perëndimor janë rrugës së mbarë drejt integritimeve euroatlantike, na jep shpresë që koncepti i multikulturalizmit i respektimit të diversitetit, të gjejë shtratin e duhur brenda shoqërive tona heterogjene, dhe e ardhmja do të jep rezultate edhe më të mira në drejtim të lehtësimit të raporteve rajonale dhe ndërkombëtare.

Vlen të përmendet se edhe Maqedonia, deri para vitit 2001, nuk ishte një shoqëri e hapur, pasi që maqedonasit që e përbënin shumicën, pothuajse çdo kulturë tjetër e dominonin, në veçanti atë shqiptare. Mirëpo fill pas vitit 2001, domethënë pas konfliktit në Maqedoni me arritjen e Marrëveshjes së Ohrit, filluan ndryshimet pozitive në të gjitha sferat. Pothuajse në të gjitha institucionet shtetërore u punësuan shqiptarë dhe pjesëtarët të komuniteteve tjera joshumicë, duke i thyer barrierat dhjetëra vjeçare. Fakt është se këto përpjekje hasën në qëndrime të forta, dhe fatkeqësisht akoma deri në ditët e sotme kemi në vend rryma ekstreme në Maqedoninë e Veriut, që i kundërshtojnë konceptet multikulturore dhe interkulturore. Por, dalëngadalë po mësohemi të bëhemi më tolerantë në mes veti, si nga pala maqedonase (edhe pse akoma kanë vështirësi të pranojnë këtë realitet), ashtu edhe nga pala shqiptare, që të jetojmë në një shoqëri të përzier kulturalisht, gjegjësisht në një shoqëri multikulturore.

Kontribut të veçantë rreth zhvillimit të multikulturalizmit po japin aktor të shumë, e në radhë të parë shoqëria civile dhe vetë institucionet shtetërore, të cilat herë-herë bëjnë fushata për të promovuar këto koncepte liberale. Në aspektin politik, kjo gjë vërehet gjithnjë e më tepër

kohën e fundit, sidomos gjatë fushatave zgjedhore, kur brenda vetë partive politike maqedonase garojnë kandidatë shqiptarë dhe anasjelltas.

Kur njerëzit mësojnë për mënyra të ndryshme të jetesës, kjo ndihmon për të thyer barrierat midis grupeve etnike të cilat shkaktohen nga mosdija e refleksioneve që sjell njohja e ndërsjellë. Të jetosh me kultura të ndryshme sjell një kuptim më të mirë të kulturave të tjera, pasuron jetën tonë dhe ndihmon në inkurajimin e tolerancës. Mirëpo si çdo punë tjetër në jetë edhe në sferën e jetesës rreth multikulturalizmit gjithmonë do ketë individë me prirje ekstreme, që mendojnë se feja, kombi, raca apo kultura e tyre është më e drejta, dhe se të gjitha të tjerat janë të gabuara. Këta njerëz përpiqen të fajësojnë pakicat etnike për problemet sociale dhe ekonomike, edhe kur nuk është e vërtetë. Për shkak të opinioneve të ndryshme, divergjente, shpeshherë ndodhin edhe trazira qytetare, ku mosdurimi përbën një problem të vazhdueshëm brenda shoqërive multikulturore.

Shpresojmë që përmes këtij hulumtimi shkencor, është arritur që të sillet një realitet sa më objektiv rreth gjendjes së multikulturalizmit veçanërisht në Maqedoninë e Veriut, ku përmes analizave, anketave dhe intervistave, kemi detektuar problemet themelore që lidhen me këtë koncept shoqëror të ne. Poashtu shpresojmë që konkluzionet e mësipërme të dhëna në formë të rekomandimeve, do të jenë në funksion të një zhvillimi sa më progresiv të konceptit të multikulturalizmit.

Rezultatet e këtij hulumtimi mund të jenë një bazë solide për vazhdimin e thelluar të problematikës në fjalë, mbase edhe nga kandidatë të tjerë, të cilët do të mund të bëjnë analiza të rasteve specifike të parafrazuara në punimin tonë, analiza të rezultateve të anketave tona kundrejt një periudhe tjetër kohore ose një target grupit tjetër, apo edhe përmes shqyrtimit të modeleve të tilla nëpër hapësira tjera gjeografike të rajonit tonë.

Bibliografia / literatura dhe burimet

1. Атанасов, Петар **Мултикултурализмот како теорија, политика и практика**, Евро-Балкан прес, Скопје, 2003
2. Атанасов, Петар **Државата, граѓаните, етничката дистанца и националниот идентитет, ПОЛИТИЧКАТА култура и идентитетите**, Фондација отворено општество-Македонија, Скопје, 2012
3. Атанасов, Петар **Македонски мултиетнички јазли: битка за едно или две општества**, Просветно дело, Скопје, 2017
4. Brown, David **Contemporary nationalism: Civic, Ethnocultural and Multicultural Politics**, London, 2000
5. Basic Goran, Zagar Mitija, Tatalovic Sinisa, **Multiculturalism in Public Polices**, Institute for Social Sciences, Beograd 2018
6. Çausidis Tamara, Zoran Bojarovski, **Doracak për etikën në gazetari**, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Shkup, 2012
7. Çupeska, Ana **Identitetet kulturore në politikë (aspektet e multikulturalizmit)**, Konrad Adenauer, Shkup, 2013
8. Festenstein M., **Negotiating diversity: culture, deliberation, trust**, Polity Press, Cambridge, 2005
9. Franoviq Ivana, Nenad Vukosavljeviq, **Padhunshmëria! Doracak trajnimesh për ndërtimin e paqes**, Aksioni Paqësor, Prilep – Tetovë, 2000
10. Hajrullahu, Arben **Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritit në BE**, Fondacioni Konrad Adenauer, Prishtinë, 2015

11. Hantke, Frank **Shoqëria civile - Demokracia - Organizatat e Shoqërisë civile**, broshurë online, (pa vit dhe vend botimi)
12. **Koncept i arsimit interkulturore**, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shkup, 2015,
13. Karlsrajter, Ana **Mediat në shoqëritë shumë-gjuhësore - Liria dhe përgjegjësia**, OSBE, Vjenë, 2003
14. Кимлика Вил, **Мультикультурно граѓанство**, ИДЦО, Скопје, 2004
15. Kymlika, Will **Multicultural Odysseys, Navigating the International Politics of Diversity**, Oxford University Press, 2007
16. Koeing, Matthias **Democratic Governance in Multicultural Societies**, Vol 2. n.11, www.unesco.org
17. **Multikulturalizmi dhe interkulturalizmi në tekstet shkollore prej klasës së parë deri në të pestën në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë**, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shkup, 2016
18. **Migrimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Profili i shtetit 2021**, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Shkup, 2022
19. Latifi, Veton **Zhvillimi i negociatave 1 (Negocimi për arritjen e Marrëveshjes së Ohrit)**, Institutit i Ohrit për Strategji Ekonomike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkup, 2007
20. Latifi, Veton **Konceptet e demokracisë**, Instituti për Demokraci dhe Zhvillim, Tetovë, 2009
21. Leung et al, **Multicultural experience enhance creativity: The when and how**, 2008
22. Martinelo, Mario **The State, The Market and Cultural Diversity**, Imigrants and Mignorities, vol.22., Taylor & Frances. Ltd. 2003
23. Mazower, Mark **Ballkani, një histori e shkurtër**, Skanderbeg Books, Tiranë, 2010

24. Michieli Tina, Lidiya Mesari, **Praktika Qytetare Ballkanike – 5, Udhëzues për dialogun civil në Ballkan**, QMBN, Shkup, 2007
25. Orosco José-Antonio, **Toppling the Melting Pot**, Indiana University Press, Indiana-USA, 2016
26. Outlaw. L. Jr., **Multiculturalism, Siticencshio, Education an American Liberal Democracy**, Theorizing Multiculturalism, A Guide ti the Current Debate, Bleckwell Publishers. Oxford, 1998
27. Pajaziti Ali, Ylber Sela, Jasmina Trajkoska, **Multikulturalizmi në Republikën e Maqedonisë : studim i rastit të Kumanovës**, Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare, Shkup, 2015
28. Petroska V., M.Najçevska, N.Kenig, S.Ballazhi, A.Tomovska, **Multikulturalizmi dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim**, UNICEF, Shkup, 2009
29. **Informim multikulturor (doracak për gazetarë)**, QMBM, Shkup, 1999
30. Sela Ylber, J.Zejneli, J.Shasivari, V.Hajretin, A.Saliu, Ll.Matovski, **Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019**, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Shkup, 2021
31. Sela Ylber, Llazo Matovski, **Aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut**, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Shkup, 2022
32. Tahiri, Sefer **Mediat dhe komunikimi ndërkulturor në Ballkan**, BALLKANOLOGJIA – 1, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, 2019
33. Скаловски, Денко **Во прво лице еднина**, Азбуки, Библиотека Филозофија - Скопје, 2010
34. **Strategjia shtetërore për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizmit**, Qeveria e R MV, Shkup, 2019

- 35. Standarde për arsim interkulturore**, Dokument i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Shkup, 2021
- 36. Shkolla e multikulturalizmit**, Civica & Antico, Shkup, 2010
- 37. The Oxford Handbook of Multicultural Identity**, Edited by Verónica Benet-Martínez and Ying-yi Hong, Oxford University Press, 2014
- 38. Vavrus Michael, Transforming the Multicultural Education of Teachers**, Teachers College Press, New York, 2002
- 39. Vlerësimi i multikulturalizmit në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë**, Asociacioni për Iniciativa Demokratike, Gostivar, 2016
- 40. Zenuni-Idrizi Valdeta, Multikulturalizmi në arsim**, CENTRUM - 7, Shkup, 2017
- 41. Прирачник за активно граѓанство / Doracak për qytetari aktive**, Форум – Центар за стратешки истражувања и документација, Shkup, 2015

Ueb faqe elektronike:

www.eeas.europa.eu
www.european-union.europa.eu
www.usaid.gov
www.fosm.mk
www.ambasadat.gov.al
www.evropaelire.org
www.zeriamerikes.com
www.bbc.co.uk/albanian
www.portalb.mk
www.alsat.mk
www.nacionale.com

www.seeu.edu.mk

www.edl.ecml.at

www.eurospeak.al

www.epi.org.mk

www.greelane.com

www.popis2021.stat.gov.mk